



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15/2022 regjistër (JR)
Datë 11.03.2022

Nr. 48 vendimit
Datë 15.10.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 15.10.2024, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Artan Lulaj, prokuror në Prokurorinë pranë në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 497, datë 13.01.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura para seancës, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Lulaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetime për 3 (tri) kriteret e vlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

2.1 ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport¹ kontrolli, në të cilin konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit Artan Lulaj:*

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- ka mosdeklarim të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport², në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. *Në përfundim të veprimeve verifikuese DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të z. Artan Lulaj.*

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.01.2018.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2021.

2.3 KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit, ka hartuar raportin³ për analizimin e aftësive profesionale të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 497, datë 13.01.2022, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Lulaj [...].*

4. Vendimi i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Artan Lulaj, është marrë bazuar në përcaktimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në referim të konkluzione të mëposhtme.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se:

i. subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë “vetting”, në përputhje me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;

ii. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklarin të pasaktë të të ardhurave të krijuara, përkatësisht nga ushtrimi i profesionit të noterit dhe nga punësimi pranë shoqërisë “{***}” ShPK, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;

iii. subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;

iv. subjekti ka fshehur në deklaratën “vetting”, por dhe në deklarinet periodike, ndërtimin e një objekti me sipërfaqe 110 m² në vitin 2003, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016;

v. Komisioni mban parasysh në vlerësimin e tij qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.

Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar se:

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.06.2021.

e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se:

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton vetëm në një çështje gabime thelbësore dhe serioze, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

4.4. Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioni ka konkluduar se:

Në vlerësimin tërësor të procedurave, lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi.

Në këto rrethana, përfshihen problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, në lidhje me (i) qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit; (ii) fshehjen nga subjekti i ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m²; si dhe (iii) faktet e sjella në vëmendje nga denoncimi dhe të provuara gjatë hetimit administrativ të procedimit penal objekt i denoncimit, pasqyrojnë gabime procedurale që tregojnë mangësi profesionale, mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie në përfaqësimin e interesit publik, që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut për organet e drejtësisë.

Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana të cituara më lart, do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 497, datë 13.01.2022, ka paraqitur ankim⁴ subjekti i rivlerësimit Artan Lulaj. Në tërësi, ankimi i subjektit përmban pretendime në drejtim të cenimit

⁴ Ankimi është regjistruar me nr. {***} prot., datë 01.03.2022. Në ankim subjekti shpjegon se vendimi i Komisionit i është komunikuar më datë 15.02.2022.

të procesit të rregullt ligjor prej Komisionit, si dhe pretendime të cilat kundërshtojnë konkluzionet për vlerësimin e pasurisë dhe të cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”):

(i) Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative nr. 497 vendimi, datë 13.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Artan Lulaj; (iii) Shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave; (iii) Ndryshimin e vendimit nr. 497, datë 13.01.2022, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Lulaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregull ligjor

6. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë.

6.1. Çështja e tij është paragjykuar në tërësi nga Komisioni, duke evidentuar si elemente që mbështesin këtë pretendim: **(i)** mosmarrjen në konsideratë të argumenteve dhe provave të paraqitura nga subjekti; **(ii)** interpretimin në të kundërt të rrethanave dhe fakteve jetësore dhe deformimin/keqinterpretimin nga Komisioni.

6.2. Komisioni si organ nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë dhe nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj në kuptim të nëntit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6.3. Në drejtim të aplikimit të ligjit prej Komisionit, subjekti pretendon se: **(i)** dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, nuk është e justifikuar pasi nuk u provua se subjekti i rivlerësimit: (a) dispononte më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme; (b) rezultonte me probleme në kontrollin e figurës; (c) kishte kryer shkelje të rënda në raport me deklarin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur; **(ii)** Komisioni ka mbajtur standarde të ndryshme lidhur me kuptimin dhe aplikimin e kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke passjellë cenim të parimit të barazisë para ligjit; **(iii)** Komisioni, duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka cenuar qëllimin për të cilin ligjvënësi ka miratuar këtë ligj.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë.

7.1. Për pasurinë apartament banimi me sip. 117 m², në rrugën “{***}” në Tiranë, subjekti e konsideron të padrejtë dhe jo në përputhje me provat e paraqitura prej tij, konkluzionin e Komisionit, pasi ai në mënyrë të gabuar ka konkluduar: **a)** për ekzistencën e një çmimi fiktiv; **b)** për mungesën e të ardhurave për rikonstruksionin dhe rimobilimin e apartamentit gjatë vitit 2014; **c)** se ka bërë deklarin të pasaktë të burimeve të financimit të këtij apartamenti; **d)** se ka kryer fshehje të pasurisë, objekti 1 kat me sip. 110 m² në Sarandë, për ndërtimin e të cilit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme; **e)** ka pasur mungesa të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së apartamentit në Tiranë, në çdo version të analizës në vitin 2001 (si në rastin kur konsideron deklarimet e deklaratës *vetting*, ashtu edhe ato të deklaratës fillestare të pasurisë).

7.2. Kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar në prova konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të realizuar pagesën e këstit të dytë të apartamentit me sip. 60 m², ndodhur në lagjen {***}, Plazh Durrës, në vlerën 5.000 euro, në vitin 2009.

7.3. Kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar: (i) konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të realizuar blerjen e automjetit tip “Ford Galaxy”, me targë {***}, me burim nga shitja e automjetit tjetër tip “Opel Corsa” në vitin 2009; (ii) konkluzionet e Komisionit për përdorimin e automjetit tip “BMW” nga vajza e tij në vitet 2011-2014.

7.4. Kundërshton si të gabuar dhe të pabazuar në akte analizën financiare të Komisionit lidhur me: (i) vlerën e të ardhurave të ligjshme të përfshira në analizën e kryer ndër vite, si të siguruara nga punësimi i bashkëshortes së tij nga shoqëria “{***}”; (ii) shpenzimet e përfshira në analizën financiare në vitin 2014 për ceremoninë familjare, dhe për kursimet në *cash*, në shumën 1.300.000 lekë.

7.5. Pretendon se është i gabuar dhe i pabazuar ligjërisht qëndrimi i Komisionit se ai ka detyrim për të shpjeguar/justifikuar pasuritë e vajzës dhe bashkëshortit të saj, të krijuara pas dorëzimit të deklaratës *vetting*.

7.6. Kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar në tërësi analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 1994- 2016.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, denoncimet dhe për vlerësimin tërësor

8. Në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe ankimi renditen si më poshtë.

8.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi dhe konkluzioni i Komisionit për procedimin penal nr. {***}, të regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, ka të bëjë me themelin e çështjes dhe se trajtimi i tij nga Komisioni, është në kundërshtim me parashikimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

8.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi dhe konkluzioni që Komisioni ka bërë për denoncimin e z. P. M. e znj. F. M., është i gabuar dhe, si i tillë, është i pambështetur në ligj dhe në prova, duke kërkuar nga Kolegji mosmarrjen në konsideratë të vlerësimit të bërë për këtë procedim penal.

8.3. Kundërshton si të pabazuar ligjërisht konkluzionin e Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të parashikuar nga neni 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë (*ratione materiae*) ankimet kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Lulaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, kryhet në dhomë këshillimi. Në rastin objekt shqyrtimi, subjekti kërkon ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 497, datë 13.01.2022, duke kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Më ankimin, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte të reja, por më datë 10.10.2024, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të tilla së bashku me parashtrimet të depozituara para seancës gjyqësore. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së parashtrimeve, rezulton se në to subjekti ka ngritur pretendime të reja apo të ndryshme nga ankimi i tij, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke synuar ndryshimin e analizës financiare të Komisionit. Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se aktet e reja të kërkuara për t'u marrë me cilësinë e provës, të paraqitura me parashtrimet, nuk meritojnë analizën sipas kushteve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, duke qenë se ajo u përket akteve që paraqiten me ankimin. Edhe në këtë rast, trupi gjykues potencon qëndrimin e mbajtur prej tij, tashmë të konsoliduar, se subjektet e rivlerësimit nuk legjitimohen të sjellin akte të reja me parashtrimet, pasi neni 49 i ligjit nr. 49/2012 nuk e parashikon këtë mundësi, ndërsa neni 47 i po këtij ligji parashikon paraqitjen e tyre me ankimin, nën plotësimin e kushteve të përcaktuara prej tij. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues vlerësoi përmbajtjen e tyre edhe në këndvështrim të së drejtës së tij për të marrë prova kryesisht, por i gjeti ato të panevojshme për t'u marrë si të tilla, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 84/2016. Për sa më lart, trupi gjykues vendosi refuzimin e marrjes së këtyre akteve me cilësinë e provës së re dhe, pasi analizoi edhe pretendimet që lidhen me procesin e rregullt

ligjor dhe shkeljet procedurale të pretenduara, të cilat do të shtjellohen në vijim, u gjend i pabazuar pretendimi i tij për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke qenë se nuk u verifikua asnjë prej situatave të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, gjykimi i saj u zhvillua në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor

12. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të adresuara ndaj shkeljeve, që sipas tij kanë cenuar procesin e rregullt ligjor, të cilat u analizuan si më poshtë.

12.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura prej tij në kuadër të mbrojtjes ndaj barrës së provës, duke identifikuar si të tilla aktet që kanë të bëjnë me regjistrat noterialë të punës së tij si noter. Po ashtu, subjekti pretendon se qëndrimi i trupës së Komisionit gjatë seancës dëgjimore se për aktet e sjella nga subjekti do të arsyetojë në vendimin përfundimtar, përbën shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe të ekzistencës së një vendimi të paragjykuar dhe të paracaktuar.

Lidhur me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues konstaton se nga analizimi i përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, si dhe i të dhënave të hetimit administrativ, rezulton se Komisioni në vendim⁵ ka mbajtur qëndrim rreth informacionit që ofrojnë kopjet e regjistrave noterialë të depozituar nga subjekti. Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se situata që subjekti ka identifikuar në ankim, se ka të bëjë me mosshqyrtimin e provave që ai ka paraqitur gjatë hetimit administrativ, në thelb konsiston në një vlerësim të ndryshëm të provave nga Komisioni prej nga sa ka pretenduar subjekti. Kjo situatë evidenton se nga Komisioni nuk ka munguar vlerësimi i provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, por se ato janë çmuar në mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë e tij, tagër i cili ushtrohet nga Komisioni sipas diskrecionit të tij dhe kompetencës që i ka dhënë neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, ky pretendim konsiderohet i pabazuar në prova dhe në ligj.

⁵ Në vendimin e Komisionit, ndër të tjera, është arsyetuar se:

“31.6. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se ka bërë vazhdimisht përpjekje për të tërhequr regjistrat, të cilët sipas informacionit nga Dhoma Kombëtare e Noterëve i kishin kaluar noterit A.A. dhe i janë vënë në dispozicion subjektit në momentin e dërgimit të rezultateve të hetimit. Me dorëzimin e këtyre regjistrave në vijim të parashtrimeve, subjekti ka pretenduar se provohet qartësisht se të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i noterit, përgjatë viteve 1991-2000, janë shumë më të larta se konkluzioni i dalë prej Komisionit.

[...]

31.8. Komisioni vlerëson se është e pamundur të llogariten të ardhurat e mundshme për vitet 1994 dhe 2000, bazuar në regjistrat noterialë të paraqitur, pasi mungon kolona e çmimit, e cila rezulton të mos jetë fotokopjuar nga subjekti.

31.9. Përpos këtij fakti, për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për vitet 1994 dhe 2000, rezulton se nuk përmbushen standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë, edhe sikur subjekti të kishte krijuar të ardhura, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit”.

12.2. Lidhur me pretendimin se Komisioni *ka paragjykuar çështjen duke interpretuar në të kundërt rrethanat dhe faktet jetësore, duke i deformuar/keqinterpretuar ato*, trupi gjykues, në referim edhe të përmbajtjes së shkaqeve të ankimit që subjekti ngre në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, vëren se ato kanë të bëjnë me mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të shpjegimeve që subjekti ka dhënë në lidhje me ndërtimin e një objekti 1 kat me sip. 110 m² në Sarandë dhe të ardhurat e përdorura për financimin e apartamentit në Tiranë me burim nga shitja e trojeve dhe apartamentit në Sarandë, për të cilat subjekti pretendon ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni. Lidhur me këto pretendime, të cilat do të analizohen më gjerësisht në pjesën vijuese të këtij vendimi, evidentohet se ato konsistojnë në drejtim të vlerës provuese që Komisioni i ka dhënë dokumentacionit zyrtar për provueshmërinë e fakteve objekt hetimi, në raport me deklaratimet e subjektit. Në këtë optikë, duket se Komisioni ka përcaktuar vlerën e tyre provuese me peshë ndikuese në konkluzionet e tij, duke mos pranuar si tilla deklaratimet/shpjegimet e subjektit, të cilat më së shumti duket se janë udhëhequr nga nevoja për përmirësimin e rezultatit të analizës financiare. Në kushtet kur në ankim subjekti nuk ka identifikuar asnjë situatë që tregon/identifikon, analizimin në të kundërt prej Komisionit të asaj që evidentojnë aktet shkresore, por ai ka mbetur në vlerësim të përgjithshëm e teorik, të pambështetur në situata faktike që pasqyrojnë këto pretendime të subjektit dhe që do të meritonin analizën më të detajuar të secilës prej tyre, trupi gjykues vlerëson se këto pretendime, përveç se kundërshtojnë në tërësi vlerësimin që ka bërë Komisioni për faktet e marra në analizë, nuk evidentojnë situata faktike që mund të analizohen në raport me shkelje të ligjit procedural apo cenim të rregullave të procesit të rregullt ligjor.

12.3 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit *për cenim prej Komisionit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe për mospërmbushje të standardit të gjykimit të çështjes në mënyrë të drejtë dhe nga një gjykatë e pavarur e krijuara me ligj, në kuptim të përcaktimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, trupi gjykues sërish konstaton se subjekti në ankim nuk ka identifikuar situatën/at, të cilat, sipas tij, përbëjnë cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, rezulton se Komisioni, në funksion të hetimit administrativ, me anë të pyetësorëve, i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit pyetje e kërkesa për të dhënë shpjegime, për të cilat jo në të gjitha rastet subjekti ka qenë i gatshëm t'i përgjigjet, situatë e cila nuk ka ndryshuar edhe pas rikërkesave për shpjegim të Komisionit. Ndërsa, në disa raste, rezulton se për pyetjet e drejtuara nga Komisioni, subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar⁶, duke sjellë si pasojë që të klasifikohet nga ky organ si jobashkëpunues, në kuptim të përcaktimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në Komision në seancën dëgjimore në të cilën ka marrë të gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur shpjegimet dhe pretendimet e tij.

Në të tilla kushte, trupi gjykues, duke mos konstatuar nga ankimi asnjë situatë konkrete e cila do të duhej të vlerësohej sipas pretendimeve për shkelje të parimeve të procesit të rregullt, si dhe në konsideratë të rrethanave të përshkruara të cilat tregojnë në tërësi se janë respektuar të drejtat e subjektit në procesin administrativ dhe madje ka pasur edhe një qëndrim jobashkëpunues prej

⁶ Siç është rasti i çështjes së vlerës së apartamentit në Tiranë, për të cilin ka refuzuar të paraqesë kontratën e sipërmarrjes, apo lidhur me objektin 1-katësh në Sarandë.

vetë subjektit, i cili duket se ka vështirësuar veprimtarinë hetimore të Komisionit, i vlerëson si të paargumentuara e të pambështetura pretendimet e subjektit.

12.4. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave *dhënia prej Komisionit e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, nuk është e justifikuar pasi nuk u provua se subjekti i rivlerësimit: (a) dispononte më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme; (b) rezultoi me probleme në kontrollin e figurës; (c) kishte kryer shkelje të rënda në raport me deklarin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur*; trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

12.5. Komisioni ka vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është konsideruar në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, të parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e saj, si dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës, në kuptim të përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues evidenton se në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, nuk referohet si shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasja e dyfishit të pasurisë së ligjshme nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, fakt i cili nuk justifikon ngritjen e një pretendimi të tillë prej subjektit. Trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i ngritur mbi një rrethanë inekzistente, e cila për më tepër as është konsideruar dhe as është marrë në analizë prej Komisionit si një shkak për shkarkimin e subjektit, nuk mund të ketë relevancë në analizën e bërë në këtë gjykim. Nga ana tjetër, trupi gjykues sjell në vëmendje se rastet për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk janë kumulative, që do të thotë se ndonëse nuk gjenden rrethana që mund të kualifikohen sipas nenit 61, pika 1 e ligjit, mund të gjenden dhe janë gjetur rrethana që kualifikohen sipas pikave të tjera të kësaj dispozite, të cilat njësoj urdhërojnë vendosjen e masës disiplinore.

12.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk plotësohet kushti i deklarimit të pamjaftueshëm njëherazi, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, siç parashikon neni 61, pika 3, trupi gjykues sjell në vëmendje se kjo çështje ka gjetur tashmë trajtim në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁷. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast, mbështetur në arsyetimin e përdorur në këtë jurisprudencë, duke iu referuar edhe përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, arrihet në konkluzionin se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra mund të jepet kur subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit nuk provon arritjen e një niveli të besueshëm qoftë edhe vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, qëndrim i konfirmuar si i tillë edhe nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen *A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë*. Në aplikim të të njëjtit arsyetim, edhe në rastin konkret, nga trupi gjykues gjendet i pambështetur edhe pretendimi i subjektit se dhënia e masës disiplinore kërkon ekzistencën në mënyrë kumulative të deklarimit të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës dhe për pasurinë.

12.7. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se në rastin e tij, *Komisioni ka mbajtur standarde të ndryshme lidhur me kuptimin dhe aplikimin e kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke passjellë cenim të parimit të barazisë para ligjit*, trupi gjykues analizon sa vijon.

⁷ *Vendimet e Kolegjit (JR) 9/2018; (JR) 7/2019; (JR) 15/2019; (JR) 24/2020.*

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të këtij pretendimi, parashtron se në raste të tjera, Komisioni ka aplikuar në mënyrë të ndryshme kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës për rastet kur ka konstatuar se nuk ka përputhje midis deklarimeve në deklaratat periodike vjetore (në vijim “DPV”) dhe në deklaratën *vetting*, apo kur nuk ka përputhje midis gjendjes së faktit dhe deklarimeve të subjekteve, raste të cilat, sipas subjektit, nga ky organ janë vlerësuar si pasaktësi dhe jo si fshehje apo si deklarime të rreme, siç janë kategorizuar në procesin e tij të rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se këto pretendime të subjektit i adresohen faktit se Komisioni, nga hetimi administrativ, ka konstatuar që subjekti në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar ndërtimin e një objekti në Sarandë, situatë e cila është klasifikuar nga Komisioni si fshehje pasurie në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues, siç do të analizojë në mënyrë të detajuar në vijim, mban një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni për sa i përket kualifikimit ligjor të situatës faktike që ka rezultuar nga hetimi, dhe që përcaktohet me mospasjen e të drejtave të pronësisë prej subjektit në këtë pasuri në momentin e përpilimit të deklaratës *vetting*. Pavarësisht këtij vlerësimi, trupi gjykues risjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, se standardet e ndryshme të mbajtura nga Komisioni për çështje të ngjashme, *së pari* nuk mund të adresohen si shkaqe ankimi, për sa kohë që u përkasin trupave gjykues të ndryshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë si të pavarur nga njëri-tjetri dhe *së dyti*, se përcaktimi i dy standardizimeve lidhet domosdoshmërisht me analizat specifike të çdo rasti, të cilat meritojnë trajtim individual e, për pasojë, krijojnë vështirësi apo edhe pamundësi për konstatimin e këtij standardi të pretenduar si të dyfishtë. Përpos këtij arsytimi, trupi gjykues sjell në vëmendje përgjegjësinë e tij si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, i cili garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, por edhe për shkak të kompozimit të tij.

12.8. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, lidhur me shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, me të cilat ai adreson pretendime lidhur me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni, trupi gjykues konkludon se ato janë të paargumentuara dhe të pabazuara ligjërisht.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionet e Komisionit *për pasurinë apartament banimi me sip. 117 m², në rrugën “{***}” në Tiranë*, sipas të cilave subjekti e konsideron të padrejtë dhe jo në përputhje me provat e paraqitura prej tij, konkluzionin e Komisionit: **a)** për ekzistencën e një çmimi fiktiv; **b)** për mungesën e të ardhurave për rikonstruksionin dhe rimobilimin e apartamentit gjatë vitit 2014; **c)** se ka bërë deklaram të pasaktë të burimeve të financimit të këtij apartamenti; **d)** se ka kryer fshehje të pasurisë objekti 1 kat me sip. 110 m² në Sarandë, për ndërtimin e të cilit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme; **e)** ka pasur mungesa të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së apartamentit në Tiranë, në çdo version të analizës në vitin 2001 (si në rastin kur konsideron deklaramet e deklaratës *vetting*, ashtu edhe ato të deklaratës fillestare të pasurisë). Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

13.1. Në vendimin e Komisionit, për këtë pasuri të blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2001, pasi janë analizuar si pjesë integrale e kësaj pasurie edhe pasuri të tjera të cilat janë krijuar në një kohë të përafërt me të dhe, për pasojë, afektojnë burimet e ligjshme për justifikimin e saj, apo shpenzimet e kryera për rikonstruksionin dhe mobilimin e kryer asaj në vitin 2014, është konkluduar për secilën prej këtyre çështjeve brenda kontrollit të kryer për këtë pasuri, sa vijon:

i. Rezulton e provuar ekzistenca e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes për këtë pasuri, si dhe subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën “vetting” në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie.

ii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën (-) 958.831 për rikonstruksionin dhe mobilimin e apartamentit në vitin 2014.

iii. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si noter.

iv. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

v. Subjekti ka fshehur në deklaratën “vetting”, por dhe në deklaramet periodike ndërtimin e një objekti me sipërfaqe 110 m² në vitin 2003.

vi. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit me sipërfaqe 110 m², në shumën 1.300.405,92 lekë.

vii. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie në shumën 1.386.608,83 lekë, nëse në analizë do të përfshihen të gjitha të ardhurat e tij deri në vitin 2001, ndërsa nëse i referohemi burimit të deklaruar nga subjekti në DPV-2003, ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 5.828.550 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit 33/5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

13.2. Lidhur me konkluzionin për ekzistencën e një çmimi fiktiv në kontratën e shitblerjes dhe deklaramin e pamjaftueshëm në deklaratën *vetting* për sa i përket çmimit të blerjes së këtij apartamenti, trupi gjykues analizon sa vijon.

13.3. Nga deklaramet që subjekti i rivlerësimit ka bërë për apartamentin në Tiranë në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaramet vjetore periodike të pasurisë, rezulton se subjekti ka deklaruar:

(i) në deklaratën *vetting*, në rubrikën e deklaramit të pasurive, pronësinë e një apartamenti të ndodhur në Tiranë, me sip. 117 m², të blerë me vlerën 3.950.000 lekë;

(ii) po në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar shpenzime rindarje të brendshme të apartamentit me sip. 117 m² në Tiranë, të kryera në vitin 2001, në shumën 2.000.000 lekë, shpenzime për mobilim të po këtij apartamenti të kryera gjatë vitit 2014 në shumën 1.500.000 lekë dhe shpenzime për ceremoninë familjare 1.000.000 lekë;

(iii) në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar se ka në pronësi një apartament banimi në Tiranë, me sip. 117 m², vlera 6 (gjashtë) milionë lekë;

(iv) në përgjigjet e dhëna në ILDKPKI më datë 03.03.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartamenti në Tiranë është blerë prej meje në vlerën 6.000.000 lekë, ashtu siç e kam deklaruar. Vlera 3.950.000 lekë është vendosur nga firma ndërtuese e këtij apartamenti. Sqaroj*

se fillimisht është lidhur një kontratë sipërmarrjeje dhe çmimi i përcaktuar në këtë kontratë ka qenë 6.000.000 lekë.

13.4. Për sa më lart, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në deklarinimin fillestar të pasurisë të vitit 2003, ka deklaruar si çmim për blerjen e apartamentit në Tiranë, një vlerë gati sa dyfishi i vlerës së deklaruar si çmimi i blerjes së apartamentit në deklaratën *vetting*. Në mbështetje të këtij konstatimi, sipas Komisionit, janë edhe deklaramet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI, ku ka deklaruar se vlera e apartamentit është në të vërtetë 6.000.000 lekë, por vlera prej 3.950.000 lekësh është vendosur nga firma ndërtuese e këtij apartamenti, duke krijuar bindjen se vendosja e vlerës prej 3.950.000 lekësh si çmim i blerjes së këtij apartamenti në kontratën e shitblerjes së tij është fiktiv dhe deklarimi i këtij çmimi në deklaratën *vetting* përbën deklarinim të pamjaftueshëm të kësaj pasurie.

13.5. Sipas kontratës noteriale të shitjes së apartamentit, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 15.07.2004, me anë të së cilës Artan Lulaj dhe bashkëshortja F. Q., në cilësinë e palës blerëse, kanë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK një apartament 2+1, me sip. 117 m², në Tiranë, i cili është i regjistruar në ZRVPP Tiranë në emër të kësaj shoqërie. Në këtë kontratë, përcaktohet se pala shitëse, këtë apartament së bashku me truallin që i takon ia shet blerësit kundrejt shumës 3.950.000 lekë, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre nga blerësi, dhe shitësi nuk ka pretendime për to.

13.6. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, për të provuar pagesat e apartamentit në Tiranë, ka paraqitur 5 (pesë) mandatarkëtime që dokumentojnë pagesat e kryera pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit, në vlerën totale 41.000 USD, konvertuar me kursin e këmbimit mesatar në USD, në vlerën 5.598.550 lekë.

13.7. Në shkresën që z. A. N., si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, drejtuar Komisionit, datë 30.09.2021, konstatohet se bashkëlidhur saj, përveç mandatarkëtimeve të mësipërme, gjendet dhe një letër format me emërtimin “Preventiv për Artan Lulaj” për punime shtesë, me vlerë totale 1.967.080 lekë.

13.8. Mbështetur në sa më sipër, konstatohet se sipas informacionit që ofrojnë mandatpagesat e paraqitura prej subjektit, por edhe shoqërisë, vlera e shpenzuar deri më 14.11.2001, nga subjekti i rivlerësimit për apartamentin në Tiranë, ka qenë në shumën 41.000 USD, e konvertuar në shumën 5.598.550 lekë. Ky informacion tregon se vetë subjekti ka depozituar dokumentacion që provon kryerjen e pagesave në vlera më të larta se çmimi që pasqyrohet në kontratën e shitblerjes dhe, për pasojë, edhe në deklaratën *vetting*. Këtë vlerë të paguar prej tij sipas dokumentacionit të sipërpërmendur, subjekti ndonëse nuk e ka deklaruar si çmim të blerjes së apartamentit, e ka deklaruar si të shpenzuar në deklaratën *vetting*, por edhe në deklaratën fillestare të vitit 2003. Mënyra e kompozimit të shumës prej 6.000.000 lekësh është detajuar në deklaratën *vetting*⁸ si e përbërë prej çmimit të shitjes dhe vlerës së paguar për

⁸ Në deklaratën *vetting*, në rubrikën e deklarinimit të pasurisë, ka deklaruar se apartamenti në Tiranë është blerë në vlerën 3.950.000 lekë dhe po në këtë deklaratë, te rubrika “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar shpenzime rindarje të brendshme të apartamentit me sip. 117 m² në Tiranë, të kryera në vitin 2001, në shumën

përfundimin e punimeve në masën prej 2.000.000 lekësh. Në këto kushte, konstatohet se deklarimi i subjektit nuk ka shmangur përlllogaritjen në analizë financiare të shumës së shpenzuar për krijimin e pasurisë apartament, në vlerën e saj totale prej 6.000.000 lekësh.

13.9. Përveç sa më sipër, rezulton se deklarimi i subjektit se çmimi i shitjes ka qenë realisht ai i përcaktuar në kontratën e shitblerjes prej 3.950.000 lekësh dhe diferenca prej 2.000.000 lekësh është shpenzuar prej atij vetë për përfundimin e punimeve në apartament, duket se merr besueshmëri edhe nga akti i titulluar “Preventiv për Artan Lulaj”, depozituar në Komision nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas të cilit vlera e punimeve shtesë në apartamentin e subjektit, ka qenë në masën 1.950.000 lekë, rrethanë që është deklaruar edhe nga subjekti në të dhënat konfidenciale të deklaratës *vetting*.

13.10. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se *së pari*, përcaktimi i çmimit të kontratës e shitblerjes në vlerën prej 3.950.000 lekësh, duket se i përgjigjet vlerës së përcaktuar si çmim shitjeje mes palëve. Diferenca prej 1.950.000 lekësh, e cila rezulton e paguar prej subjektit mbi këtë çmim, duket se u përgjigjet punimeve shtesë të kryera në apartament e të paguara si shpenzim më vetë, sipas preventivit të hartuar në vitin 2001 për përcaktimin e saj. *Së dyti*, subjekti ka deklaruar plotësisht në deklaratën *vetting*, vlerën e shpenzuar për fitimin e pronësisë apartament, duke specifikuar se ajo përbëhet nga çmimi i shitjes dhe shpenzimet shtesë për përfundimin e punimeve, në total në vlerën prej 5.828.550 lekësh, e cila i është ngarkuar si shpenzim në analizën financiare të kryer për kontrollin e kësaj pasurie. *Së treti*, kjo vlerë përkon pothuaj plotësisht me vlerën e deklaruar si të shpenzuar për pasurinë në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, përrreth 6 milionë lekë. *Së katërti*, në cilësinë e palës blerëse në të cilën gjendet subjekti, në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit të aplikueshëm për tatimin mbi të ardhurat (ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar), ai ka qenë i zhveshur nga detyrimi për pagimin e tatimeve për vlerën e shitjes së apartamentit në Tiranë, në këtë mënyrë nuk konstatohet asnjë përfitim financiar prej subjektit me deklarimin e një çmimi më të ulët për blerjen.

13.11. Në analizë të konkluzioneve si më sipër, trupi gjykues e gjen të padrejtë konkluzionin e Komisionit se çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes është fiktiv dhe se, për pasojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me të. Në këtë konkluzion mbahet në vëmendje edhe qëllimi për të cilin kryhet kontrolli i pasurive, i cili është në thelb verifikimi i burimeve financiare të përdorura për krijimin e tyre dhe përderisa nga deklaratimet e analizuara si më sipër, nuk konstatohen përpjekje për të deformuar në ndonjë mënyrë shpenzimet e kryera prej subjektit në funksion të lehtësimit të pozitës së tij në raport me burimet financiare, mënyra se si subjekti ka zgjedhur të deklarojë vlerën e shpenzuar për krijimin kësaj pasurie, çmim + shpenzime shtesë të kryera, çmohet se nuk përfshihet në kualifikimin e një deklarimi të pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

13.12. Me tej, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e financimit të apartamentit në Tiranë, duke u ndalur fillimisht në analizimin e

2.000.000 lekë; duke passjellë që për efekt të analizës financiare që është kryer në Komision dhe Kolegj, apartamenti në Tiranë të përlllogaritjet në shumën 5.598.550 lekë.

pretendimit të subjektit, se nuk është i drejtë dhe i bazuar konkluzioni i Komisionit se ai ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për sa u përket të ardhurave të ligjshme të siguruara nga punësimi i tij si noter (të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë), për të cilin konstatohet dhe analizohet sa vijon.

13.13. Në vendimin e Komisionit, pasi janë marrë në analizë të gjitha burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *vetting* si të përdorura për financimin e apartamentit në Tiranë⁹, trupi gjykues është ndalur fillimisht në të ardhurat e krijuara nga punësimi i subjektit, për të cilat ka konkluduar se:

A. Lidhur me të ardhurat e siguruara nga puna si noter në periudhën 1994-2000:

Komisioni vlerëson se është e pamundur të llogariten të ardhurat e mundshme për vitet 1994 dhe 2000, bazuar në regjistrat noterialë të paraqitur, pasi mungon kolona e çmimit, e cila rezulton të mos jetë fotokopjuar nga subjekti. Përpos këtij fakti, për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për vitet 1994 dhe 2000, rezulton se nuk përmbushen standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë, edhe sikur subjekti të kishte krijuar të ardhura, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹⁰.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit të noterisë, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk përputhen në vlerë me të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë “vetting”. Deklarimi i subjektit në këtë rast, vlerësohet nga trupi gjykues si deklaram i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016¹¹.

13.14. Në ankim, subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga punësimi i tij si noter në Sarandë, në periudhën 1994-2000, pretendon sa vijon:

Për sa u përket të ardhurave nga funksioni si noter në qytetin e Sarandës, Komisioni, pas rikryerjes së analizës financiare lidhur me këto të ardhura, konkludoi se e ardhura totale për këtë aktivitet, përkon në shumën prej 4.947.825 lekësh. Lidhur me mosnjohjen dhe mospërfshirjen në analizë të regjistrave noterialë të kërkuar nga vetë Komisioni, vlerësojmë se ky qëndrim i Komisionit është i padrejtë. Regjistrat nuk janë fotokopjuar nga ana ime, por nga noteri që i posedon ato, bashkëlidhur me shkresën përcjellëse nga ana e tij. Kam ushtruar funksionin e noterit pranë qytetit të Sarandës, prej vitit 1991 e deri në dhjetor të vitit 2000, kohë në të cilën, më pas, mora detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore dhe pastaj të Prokurorit. Komisioni duhej t'i kishte trajtuar dhe vlerësuar këta regjistra, pavarësisht faktit se nuk përcaktohen tarifa në përmbajtjen e tyre, fakt i cili nëse do ekzistonte, do të kishte qenë në favorin tim. Të ardhurat e mundshme mund të llogariteshin në bazë të tarifave të akteve noteriale të kohës, të miratuara nga Ministria e Drejtësisë, me të cilat është bërë edhe llogaritja

⁹ Në deklaratën “vetting”, për apartamentin në Tiranë, subjekti ka deklaruar si burime financimi: të ardhurat e siguruara nga puna si noter; shitja e një apartamenti banimi; si dhe dy sipërfaqe trualli në qytetin e Sarandës.

¹⁰ Vendimet (JR) nr. 3/2018, datë 17.7.2018; (JR) nr. 4/2018, datë 25.10.2018; (JR) nr. 6/2018, datë 13.9.2018; (JR) nr. 9/2018, datë 24.10.2018.

¹¹ I njëjti qëndrim është mbajtur dhe nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 20/2021, datë 14.7.2021.

nga ana ime në analizën financiare të paraqitur pranë Komisionit dhe të cilën KPK-ja nuk e ka marrë parasysh. Gjithashtu, duhet të evidentoj para trupës së Kolegjit, që pavarësisht se Komisioni ka shtuar të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i noterit, sërish nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare të kryer, sjellje të Komisionit të cilat janë kontradiktore në vetvete dhe cenojnë procesin e rregullt ligjor.

13.15. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pasi analizoi qëndrimet e mbajtura nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, si dhe aktet e administruara nga hetimi administrativ, vëren se Komisioni, të ardhurat e siguruara prej subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti si noter, i ka përlllogaritur duke u referuar në informacionin që ofron shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Sarandë (në vijim “DRT Sarandë”) me nr. {***} prot., datë 08.11.2021, në të cilën evidentohet se subjekti ka paguar detyrime tatimore për aktivitetin si noter, vetëm për periudhën nga viti 1995 deri në vitin 1999 (respektivisht 5 vite).

Mbi bazën e këtij informacioni, Komisioni ka identifikuar xhiron vjetore dhe duke aplikuar një marzh fitimi rreth 75% të xhiros¹², ka përlllogaritur shumën totale të krijuar nga aktiviteti si noter deri në vitin 2000, e cila ka rezultuar në vlerën prej 4.947.825 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me këtë përlllogaritje të kryer nga Komisioni në rezultatet paraprake të hetimit administrativ, si dhe në vendim, nuk e ka kundërshtuar atë si në Komision, ashtu edhe me ankimin për sa i përket metodologjisë së përlllogaritjes së fitimit mbi xhiron vjetore të përlllogaritur, por ka pretenduar se në analizë mungojnë të ardhurat e vitit 1994 dhe të vitit 2000, vite për të cilat ai pretendonte se kishte kryer aktivitet si noter, edhe pse administrata tatimore Sarandë nuk evidenton asnjë të dhënë për xhiron e realizuar e, për pasojë, as për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

13.16. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera 4.947.825 lekë, e identifikuar nga Komisioni si e ardhur me burim nga aktiviteti si noter, nuk është e saktë, dhe ka kërkuar që e ardhura e siguruar të përlllogaritet duke konsideruar vlerën e çdo akti që evidentohet në regjistrat noterialë që subjekti ka hartuar gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij. Me këtë pretendim, subjekti kërkon të merret në konsideratë informacioni që ofron dokumenti i emërtuar “Libri i veprimeve noteriale”, të cilin subjekti e ka paraqitur si provë në Komision gjatë hetimit administrativ. Të njëjtin pretendim, subjekti i rivlerësimit e ka përsëritur edhe me parashtrimet e paraqitura në Kolegj para seancës gjyqësore, në të cilat ka kërkuar që për këtë element të analizës financiare të Komisionit, të konsiderohet qëndrimi i mbajtur nga Kolegji¹³ në vendimin (JR) 20/2023, datë 03.05.2023, në të cilin për identifikimin e të ardhurave për një rast të ngjashëm, është pranuar përlllogaritja e të ardhurave vjetore mbi informacionin që ofron regjistri i veprimeve noteriale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

13.17. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues, duke e vlerësuar atë në raport me qëndrimin për një situatë të ngjashme të mbajtur në vendimin e Kolegjit (JR) 20/2023, konstaton sa vijon.

¹² Fitimi në masën 75% të xhiros është një element i analizës financiare i cili nuk është kontestuar nga subjekti as në Komision dhe as me ankimin.

¹³ Shih vendimin e Kolegjit (JR) 20/2023:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2023/10/Vendimi_B._M._perفشire_mendimin_e_pakices_anonimizuar.pdf.

Së pari, në çështjen objekt analize, nga analizimi i informacionit që ofron akti i emërtuar “Libri i veprimeve noteriale”, i hartuar nga subjekti i rivlerësimit Artan Lulaj, për periudhën 1994-2000, konstatohet se nuk ka të dhëna për vlerën e paguar nga palët¹⁴ për aktet e evidentuara në këtë libër/regjistër si të hartuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e noterit.

Së dyti, në rastin objekt shqyrtimi, konstatohet se përveç mungesës së të dhënave të kohës që dëshmojnë për pagesat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit për aktet e evidentuara në regjistër, rezulton se për periudhën 1995-1999, një organ shtetëror, në këtë rast DRT Sarandë, ka identifikuar pagesën e tatimit të realizuar nga subjekti, e cila është një e dhënë që nëpërmjet zbatimit të një formule matematikore, në varësi të legjislacionit të kohës, të çon në identifikimin e qarkullimit vjetor të veprimtarisë së ushtruar prej subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, lidhur me pretendimin e subjektit për të përlllogaritur të ardhurat nga aktiviteti i tij si noter, duke aplikuar për çdo akt noterial tarifat e kohës të miratuara nga Ministria e Drejtësisë, trupi gjykues çmon se do të ishte alternativa/modeli i analizës financiare për t’u aplikuar në rast se Komisioni do të ishte në pamundësi për të identifikuar mbi baza dokumentacioni të lëshuar nga organe tatimore, qarkullim faktik të subjektit nga aktiviteti si noter nga dokumentacioni tatimor [*situatë e cila ka rezultuar në çështjen për të cilën Kolegji ka dhënë vendimin (JR) 20/2023*].

13.18. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se përlllogaritja e kryer nga Komisioni për të identifikuar të ardhurat e siguruara prej subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i tij si noter, duke u bazuar në të dhënat që ofron shkresa e DRT Sarandë, me nr. {***} prot., datë 08.11.2021, është metodologjia e duhur dhe e saktë e ndërtuar mbi baza ligjore, për kryerjen e analizës financiare, pasi rezulton të jetë bazuar në informacionin që vjen nga dokumente shkresore me vlerë të plotë provuese, të lëshuara nga organi kompetent, në këtë rast administrata rajonale tatimore Sarandë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në grupin e të ardhurave nga aktiviteti noterial edhe ato të cilat ai i identifikon si të ardhura që u përkasin viteve 1994 dhe 2000, që janë vite për të cilat nuk provohet as qarkullimi vjetor dhe as provohet se janë paguar detyrimet tatimore, është një pretendim i pabazuar në prova e i mbetur në nivel deklarativ. Gjithashtu, trupi gjykues sjell në vëmendje se pretendimi i subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhura nga aktiviteti i tij si noter në vitin 1994 dhe 2000, duket se është në kundërshtim me përcaktimin për “të ardhurat e ligjshme” të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit, e cila ka mirëpërcaktuar se për efekt të analizës financiare, do të përfshihen si të ardhura vetëm ato vlera për të cilat provohet pagimi i detyrimeve tatimore, dhe jo vlerat e pretenduara që nuk mbulohen me pagimin e tatimit respektiv.

13.19. Për të ardhurat nga aktiviteti si noter, ndonëse në ankim subjekti i rivlerësimit ngre pretendime vetëm për të përlllogaritur këto të ardhura, duke iu referuar çdo akti që figuron në regjistrin noterial të hartuar prej tij, trupi gjykues konstatoi se në parashtrimet e paraqitura para seancës gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka ngritur edhe një kërkim të ri, duke pretenduar që marzhi i fitimit mbi qarkullimin vjetor të identifikuar të jetë jo në masën 75%,

¹⁴ Në këto kushte, duket se rasti konkret nuk paraqitet i ngjashëm me situatën e analizuar nga Kolegji në vendimin (JR) 20/2023, pasi në këtë të fundit, subjekti kishte paraqitur regjistrin noterial të personit të lidhur tek i cili ishin të regjistruara edhe pagesat e marra nga noteri për hartimin e akteve dhe administrata tatimore ishte shprehur se nuk kishte të dhëna për xhiron në vite të caktuar nga ky aktivitet.

por në masën 80%. Në parashtrime, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të këtij pretendimi, evidenton se marzhi i fitimit në masën 80% të qarkullimit vjetor, është një e dhënë e aplikuar nga Kolegji në raste të tjera të ngjashme, duke identifikuar si të tillë vendimin (JR) 20/2023.

13.20. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, *së pari*, konstatohet se për aktivitetin si noter të subjektit, marzhi prej 75% të fitimit mbi qarkullimin vjetor të deklaruar, është përcaktuar në këtë nivel nga Komisioni. Ky organ, me rezultatet e hetimit administrativ¹⁵, i ka bërë me dije subjektit të rivlerësimit metodologjinë e përlllogaritjes së fitimit me marzhin 75% të qarkullimit të deklaruar, duke e evidentuar atë në mënyrë të qartë, edhe në formë tabelare, dhe rezulton se për këtë element të analizës financiare, subjekti në asnjë moment gjatë hetimit administrativ, nuk ka pretenduar për një marzh më të lartë fitimi. *Së dyti*, trupi gjykues evidenton se në rastin kur marzhi i fitimit është përlllogaritur në masën 80% të qarkullimit vjetor të deklaruar (si në vendimin (JR)20/2023), rezulton se marzhi i fitimit në këtë nivel ka qenë i përcaktuar në vendimin/analizën e Komisionit dhe, si i tillë, nuk është ndryshuar gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, edhe pse palët kanë pretenduar rritjen e tij. Në rastin konkret, trupi gjykues ka arsyetuar se në kushtet kur subjekti nuk ka kontestuar në Komision kryerjen e analizës financiare për të ardhurat e tij nga noteria me marzh fitimi në masën 75% të qarkullimit vjetor, do të thotë se ai, duke qenë personi që ka informacion edhe për shpenzimet që ka pasur në ushtrimin e aktivitetit si noter, të cilat mund të jenë të ndryshme rast pas rast, në varësi të kushteve dhe rrethanave ku zhvillohet aktiviteti noterial, duket se ka dakordësuar me këtë marzh, madje dhe e ka konfirmuar atë me ankimin, meqenëse në përlllogaritjet e kryera në ankim në mënyrë tabelare, subjekti ka pasqyruar të njëjtin marzh fitimi.

Në këto kushte, trupi gjykues, pretendimin e subjektit të rivlerësimit të ngritur në parashtrime, për të përlllogaritur për aktivitetin e tij si noter një marzh fitimi në masën 80% të qarkullimit të deklaruar, e konsideron si një pretendim të ri, të ndryshëm nga ankimi, që bie ndesh me përcaktimet e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, i orientuar nga synimi për përmirësimin e rezultatit të analizës financiare.

13.21. Po ashtu, në parashtrime, në ndryshim nga ankimi, subjekti i rivlerësimit ka ngritur edhe pretendimin për rikalkulimin e qarkullimit vjetor, duke u bazuar në përqindjet e detyrimeve tatimore të përcaktuara për t'u pagur, duke pretenduar se: **(i)** tatimet e paguara prej tij në vitet 1995 dhe 1996 përfaqësojnë 4% të qarkullimit dhe jo 5%, siç e ka përlllogaritur Komisioni dhe ai vetë në ankim: **(ii)** për vitin 1998, pretendon që detyrimet tatimore të paguara prej tij, të konsiderohen në masën 3% të qarkullimit, dhe jo në masën 4%, të përlllogaritura nga Komisioni dhe nga vetë subjekti në ankim.

Ndërsa për vitin 1999, në parashtrime, në analizën e paraqitur si një pretendim i ri, subjekti ka rritur vlerën e qarkullimit të deklaruar në organet tatimore nga 1.900.000, të përlllogaritur nga Komisioni si dhe vetë ai në ankim, duke e çuar atë në masën 2.000.000 lekë.

¹⁵ Në faqen 12 të aktit të emërtuar "Rezultatet e hetimit administrativ", të hartuar nga Komisioni, është përcaktuar se: "Për të llogaritur fitimin e subjektit nga ushtrimi i aktivitetit si noter, është konsideruar një marzh fitimi në masën 75% mbi qarkullimin e deklaruar/vlerësuar për periudhën 1994 -1999, bazuar në praktikën e aplikuar nga Komisioni në rastet e ngjashme (referuar vendimit nr. 339, datë 19.01.2021; vendimit nr. 40, datë 17.07.2018; vendimit nr. 64 datë 10.9.2018).

13.22. Lidhur me këto pretendime të subjektit, *së pari*, trupi gjykues mori në analizë informacionin që ofrojnë aktet e administruara nga hetimi administrativ, nga të cilat rezultoi se:

Për vitin 1996, në fashikullin e ILDKPKI-së, gjendet deklarata e emërtuar “Akt tatimor përfundimtar për vitin 1996”, i mbajtur më Degën e Tatimeve dhe Taksave Sarandë më datë 30.01.1997, nënshkruar nga subjekti dhe i miratuar nga kryetari i Degës së Tatimeve, tek e cila përcaktohet se tatimi i paguar nga subjekti, përfaqëson 5% të qarkullimi vjetor. Për vitin 1999, po ashtu në fashikullin e ILDKPKI-së, gjendet akti i emërtuar “Deklaratë parashikuese”, me datë 03.03.1999, tek e cila evidentohet se për periudhën 01.01.1999 deri më 31.12.1999, xhiroja vjetore do të jetë 1.900.000 lekë dhe tatimi do të jetë në kuotë fikse 70.000 lekë, e dhënë e cila është konfirmuar edhe nga subjekti në analizën e tij të paraqitur për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, si dhe në ankim. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto akte të kohës japin një informacion të ndryshëm nga ai që pretendon subjekti lidhur me qarkullimin vjetor, të cilat provojnë se përllogaritjet e bëra nga Komisioni janë të sakta dhe të bazuara.

Së dyti, trupi gjykues konsideroi faktin se subjekti i rivlerësimit i ka ngritur këto pretendime vetëm me parashtrimet dhe nuk ka paraqitur asnjë informacion apo të dhënë për mosparaqitjen e këtyre pretendimeve në Komision apo me ankimin. Në përfundim, trupi gjykues pretendimin e subjektit për rikalkulim të qarkullimit vjetor, e konsideroi të pabazuar në akte të kohës dhe të pabazuar ligjërisht.

13.23. Për sa më sipër, mbi bazën e konkluzioneve të arritura mbi këto shkaqe ankimi, në Kolegj u krye analiza financiare e subjektit për të identifikuar të ardhurat e krijuara nga aktiviteti si noter deri në vitin 2000, nga e cila u konstatua se të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si noter, për periudhën 1995-1999, u përllogaritën në shumën 4.947.825 lekë, në të njëjtën vlerë me atë që ka konstatuar Komisioni.

13.24. Trupi gjykues e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të këtyre të ardhurave në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi në vlerësimin e trupës, në këtë rast subjekti ka dështuar të provojë vlerën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara dhe, për këtë problematikë, ai ka marrë pasojën e mosllogaritjes së tyre në analizën financiare, por kjo situatë nuk duhet të barazohet me një deklaram të pasaktë duke e ndëshkuar atë dy herë për të njëjtën shkelje.

14. *Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me të cilin kundërshton konkluzionet e vendimit të Komisionit lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhura të pretenduara si të siguruara nga shitja e apartamentit në Sarandë, për të cilin konstaton dhe analizon sa vijon.*

14.1. Komisioni, lidhur me të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamentit në Sarandë, ka konkluduar se:

Bazuar dhe në përgjigjen e subjektit në seancë dëgjimore, të cilat janë kontradiktore, vlerëson se edhe sikur subjekti të provonte pagimin e detyrimeve tatimore, për sa kohë subjekti nuk provoi me dokumentacion se të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në qytetin e Sarandës, janë përfituar para kryerjes së pagesave të apartamentit në qytetin e Tiranës, e bëjnë të parëndësishëm faktin nëse për këto të ardhura janë paguar ose jo detyrimet tatimore. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare këto të ardhura.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë, për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “vetting” të saktë, nuk gjen zbatim. Komisioni çmon të vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie.

14.2. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin, e konsideron të padrejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të kryer për apartamentin në Tiranë, të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit në Sarandë, duke pretenduar se:

[...] Nga ana e Komisionit, në mënyrë të padrejtë, nuk merret parasysh e ardhura e ligjshme e përfituar nga ana ime në momentin e tjetërsimit të apartamentit në Sarandë, me argumentin se "subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në qytetin e Sarandës.

*Pamundësia objektive për të vënë në dispozicion këtë mandat, sikurse është tatimi në vlerën 0,5% të vlerës së çmimit të shitjes (sipas parashikimit të ligjit të kohës, me nr. 8438, datë 24.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i pandryshuar deri në vitin 2002), vërtetohet me shkresën me nr. prot. {***}, datë 23.09.2021, të lëshuar nga ky organ publik, pra zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shkresë që i është vënë në dispozicion trupës së Komisionit, ku përveç se informohet për detyrimin për pagesë të tatimit, gjenden gjithashtu "kopje të dokumentacionit për procedurën e asgjësimit të aplikimeve dhe mandatpagesave". Pra, tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Nisur nga kjo situatë ligjore që mund të krijohet dhe është krijuar në rastin konkret, vetë ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve", në nenin 32, pika 2 e tij, ka parashikuar se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor” [...].*

14.3. Trupi gjykues, për t’i dhënë përgjigje këtij shkaku ankimi që lidhet me mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit në Sarandë, mori në shqyrtim çështjet si vijojnë. **(i)** Për shkak të kohës kur është realizuar shitja e apartamentit në Sarandë, a mund të përbëjnë të ardhurat e realizuara prej saj burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë? **(ii)** Si ndikon në konsiderimin e kësaj të ardhure, pagimi/mospagimi nga subjekti i rivlerësimit i detyrimeve tatimore që lindin për shkak të përfitimit të saj?

14.4. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë elementin që ka të bëjë me kohën e realizimit të shitjes së apartamentit në Sarandë, në funksion të përdorimit të kësaj të ardhure si burim i financimit të blerjes së apartamentit në Tiranë, për të cilin konstaton sa vijon.

14.5. Lidhur me kohën e realizimit të së ardhurës, trupi gjykues, nga analiza e të dhënave të dosjes, konstaton se subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur

mandatarkëtimet¹⁶ që provojnë pagesat e kryera pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vlerën totale 41.000 USD. Sipas tyre, provohet se këto pagesa janë kryer nga subjekti në periudhën kohore 30.05.2001 deri më 14.11.2001, në referim edhe të përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes të lidhur me shoqërinë e ndërtimit.

14.6. Gjithashtu, në analizë të informacionit që ofrojnë aktet e fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se kontrata e shitjes së apartamentit në Sarandë nga subjekti i rivlerësimit, është bërë më datë 28.09.2001, dhe se pagesat e apartamentit në Tiranë nga subjekti i rivlerësimit kanë përfunduar me pagesën e mandatarkëtimit të fundit nr. {***}, me vlerë 5.000 USD, më datë 14.11.2001, dhe se mandatpagesa e parafundit, ajo e kryer me mandatarkëtimin nr. {***}, me vlerë 8.000 USD, është bërë më datë 26.09.2001. Nga këto të dhëna, evidentohet se ndërsa shitja e apartamentit në Sarandë është realizuar më datë 28.09.2001, dhe nuk ka të dhëna të kohës që provojnë se çmimi i shitjes prej 1.500.000 lekësh të jetë përfituar nga subjekti përpara kësaj date (*siç mund të ishin transfertat bankare*), duket e pamundur që këto të ardhura të kenë shërbyer për të kryer pagesat për blerjen e apartamentit në Tiranë deri në këstin e parafundit, të datës 26.09.2001. E vetmja vlerë, e cila potencialisht mund të jetë shlyer nëpërmjet të ardhurës së krijuar nga shitja e apartamentit në Sarandë, është vlera prej 5.000 USD, evidentuar si e paguar me mandatpagesën e datës 14.11.2001.

14.7. Për rrjedhojë, trupi gjykues, për efekt të analizës financiare, pranoi se me burimet e siguruar nga shitja e apartamentit në Sarandë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi maksimalisht për të kryer vetëm pagesën sipas mandatarkëtimit të fundit, në vlerën prej 5.000 USD.

14.8. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurën e siguruar nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e apartamentit në Sarandë, konstatohet se:

Së pari, me kontratën noteriale, të emërtuar “Kontratë shitblerje”, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 28.09.2001, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja i kanë shitur palës blerëse Q. B. dhe E. B., një apartament banimi në Sarandë me çmimin 1.500.000 lekë. Në kontratë përcaktohet se blerësit pranojnë blerjen e apartamentit me çmimin 1.500.000 lekë, shumë e cila *iu pagua* tërësisht këtyre shtetasve jashtë kësaj zyre, duke u likuiduar tërësisht ata.

Së dyti, nga të dhënat e administruara prej Komisionit në praktikën e përcjellë nga ASHK, dega Sarandë, lidhur me shitjen e apartamentit në Sarandë, nuk rezulton të jenë të përfshira akte apo të dhëna që provojnë pagesën e detyrimeve tatimore për vlerën e shitjes së këtij apartamenti, në kuptim të zbatimit të përcaktimeve të ligjit nr. 8438, datë 29.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”).

14.9. Në ankim, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit kërkon të konsiderohet qëndrimi i mbajtur nga ASHK Vendore Sarandë, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.09.2021, në të cilën pasqyrohet se: *në bazë të procesverbalit të datës 26.05.2018,*

¹⁶ Këto mandatarkëtime kanë të dhënat si vijojnë:

- (i) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 30.05.2001, me vlerë 13.000 USD;
- (ii) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 23.06.2001, me vlerë 230.000 lekë;
- (iii) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 06.09.2001, me vlerë 15.000 USD;
- (iv) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 26.09.2001, me vlerë 8.000 USD;
- (v) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 14.11.2001, me vlerë 5.000 USD.

është bërë asgjësimi i mandatpagesave dhe i vlerave për vitet 2000-2007, si dhe evidenton se: në bazë të ligjit nr. 8438, datë 29.12.1998, i ndryshuar, përcaktohet se tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë dhe se pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa u provuar pagimi i detyrimit pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Duke u referuar në këtë shkresë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar pagesën e tatimit mbi të ardhurën e siguruar nga shitja e apartamentit në Sarandë në vitin 2001, situatë e cila duhet të klasifikohet nga Kolegji sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2¹⁷ e ligjit nr. 84/2016.

14.10. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi fillimisht se nga praktika e përcjellë nga ASHK Vendore Sarandë, gjendet kërkesa e subjektit të rivlerësimit e datës 28.09.2001, për fshirjen e regjistrimit nga libri i hipotekës për pasurinë e paluajtshme apartament në Sarandë (regjistruar në {***}, faqe {***}), pasi me kontratën e shitjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 28.09.2001, këtë pasuri e ka shitur te shtetasit Q. dhe E. B., ZRVPP Sarandë ka kaluar pronësinë mbi këtë apartament në emër të blerësve. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se duke iu referuar elementeve, si : **(i)** koha e largët kur ka ndodhur shitja e apartamentit në Sarandë, pra vitit 2001, kohë në të cilën nuk ishte miratuar ligji nr. 9049/2003 për deklarimin e pasurisë; **(ii)** fakti që kalimi i pronësisë nga subjekti i rivlerësimit te pala blerëse nuk mund të ketë ndodhur pa u përmbushur pagimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Sarandë; si dhe **(iii)** informacioni që ofron shkresa e ASHK Vendore Sarandë, se është bërë asgjësimi i mandatpagesave të vlerave të paguara për vitet 2000-2007, duket se provojnë një situatë që e vendos subjektin në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

14.11. Në këto kushte, trupi gjykues konsideroi si të drejtë pretendimin që për efekt të analizës financiare, të pranojë që pagesa e realizuar nga subjekti si pagesë në *cash* pranë shoqërisë së ndërtimit, në vlerën 5.000 USD, nëpërmjet mandatpagesës së datës 14.11.2001, është paguar me fondet e siguruar nga shitja e apartamentit në Sarandë.

- 15.** *Trupi gjykues, në vijim, lidhur me analizën e burimeve të financimit të apartamentit në Tiranë, mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton si të padrejta konkluzionet e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të kryer për apartamentin në Tiranë, të ardhurat e siguruar nga shitja e dy trojeve në Sarandë me sip. 314 m² dhe 662 m², për të cilat konstaton dhe analizon sa vijon.*

15.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të siguruar nga shitja e dy trojeve në Sarandë, është konkluduar se:

Duke marrë në konsideratë faktin se trualli me sipërfaqe 314 m² është shitur më vonë se pagesat e kryera nga subjekti për apartamentin me sipërfaqe 117 m²; si dhe subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me të ardhurat e përfituara

¹⁷ Në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se:

“[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

nga shitja e kësaj pasurie; nuk do të përfshijë në analizë financiare për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m², shumën e përfiturar nga shitja e truallit me sipërfaqe 314 m² në qytetin e Sarandës. [...]

Në përfundim, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë; për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “vetting” të saktë, nuk gjen zbatim. Në të njëjtën mënyrë si më lart, Komisioni do ta vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kësaj pasurie.

Lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e truallit me sipërfaqe prej 662 m², Komisioni ka konkluduar në mënyrë të ngjashme se: subjekti, me kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 4.11.2003, ka blerë nga Bashkia Sarandë një sipërfaqe trualli prej 662 m², e destinuar për “banesë”, e ndodhur në Sarandë, kundrejt shumës 397.200 lekë. Kjo shumë është likuiduar tërësisht, sipas dokumentit bankar, datë 30.10.2003, në favor të Degës së Thesarit.

Komisioni konstaton se shitja e pasurisë së mësipërme nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 117 m², për sa kohë është shitur 2 vjet pas pagesës së çmimit të apartamentit. [...]

Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së mësipërme, subjekti ka paraqitur të njëjtat argumente si në pikën 32.2, 33.6 dhe 33.7 të këtij vendimi. Komisioni, bazuar në të njëjtin arsyetim si në pikën 32.6 dhe 32.8 të këtij vendimi, vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga shitja e truallit me sipërfaqe 662 m² dhe objektit me sipërfaqe 110 m² në qytetin e Sarandës.

15.2. Me ankimin, subjekti ashtu siç ka pretenduar edhe në Komision, kërkon, ndër të tjera, të konsiderohen si burim të ardhurat që kanë shkuar për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2001, ato të siguruara nga shitja e trojeve në Sarandë me sip. 314 m² dhe me sip. 662 m². Në ankim, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dhënë shpjegime të tjera të ndryshme nga ato të paraqitura në Komision, duke pretenduar se nga blerësit, çmimet e shitjes së dy trojeve në Sarandë i janë paguar subjektit para lidhjes së kontratës noteriale të shitjes së tyre, duke mundësuar në këtë mënyrë përdorimin e tyre si burim financimi për apartamentin në Tiranë¹⁸.

15.3. Trupi gjykues, për shqyrtimin e plotë të këtij shkaku ankimi, mori në analizë të dhënat që ofrojnë aktet e administruara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë nga subjekti i rivlerësimit, i dy trojeve në Sarandë, si dhe informacioni që ofron praktika e shitjes së tyre, nga të cilat rezulton sa vijon. **(i)** Pasuria truall me sip. 314 m², është përfiturar prej subjektit të rivlerësimit nga Bashkia Sarandë me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., më datë 21.12.2001, me çmimin 150.720 lekë. Në vijim, trualli me sip. 314 m² është shitur nga subjekti i rivlerësimit me anë të kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., lidhur më datë 09.01.2002, për vlerën 500.000 lekë. **(ii)** Pasuria truall me sip. 662 m², është përfiturar prej subjektit të rivlerësimit nga Bashkia Sarandë me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 04.11.2003, me çmimin 397.200 lekë. Në vijim, trualli me sip. 662 m², së bashku me një objekt 1 kat mbi të, është

¹⁸ Për apartamentin në Tiranë, kontrata e shitblerjes është lidhur në vitin 2004, por pagesa e plotë e tij, sipas informacionit që ofrojnë mandatpagesat, rezulton të jetë kryer në periudhën maj – nëntor 2001.

shitur nga subjekti i rivlerësimit me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2004, për vlerën 1.324.000 lekë.

15.4. Nga informacioni i mësipërm që rezulton nga praktikat e përcjella në Komision nga ASHK Zyra Vendore Sarandë, trupi gjykues konstaton se shpjegimi i dhënë nga subjekti në Komision, si dhe në ankim, se është bërë pronar i dy trojeve në Sarandë në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. {***}, datë 28.08.1999, nuk qëndron, pasi rezulton se ky është një vendim i cili nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit tagra pronësie, por nëpërmjet tij, ky organ kolegjal duket se i ka hapur subjektit rrugën për të vijuar procedurat për blerjen e këtij trualli me sip. 314 m², e cila është realizuar me anë të kontratës së shitblerjes së nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të Bashkisë Sarandë, më datë 21.12.2001, pasi më parë, më datë 18.12.2001, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet një transferte bankare, ka paguar në favor të Seksionit të Financës e Thesarit të Bashkisë Sarandë, çmimin 150.720 lekë për blerjen e këtij trualli.

15.5. Në analizë të informacionit që ofron praktika e ASHK-së, konstatohet se trualli me sip. 314 m², është një pasuri për të cilën subjekti jo vetëm shitjen, por edhe blerjen e saj e ka realizuar pas datës 14.11.2001, kur kanë përfunduar pagesat e apartamentit në Tiranë. Në vijim të analizës, trupi gjykues evidenton se e njëjta situatë konstatohet edhe për truallin me sip. 662 m² në Sarandë, për të cilin pagesa e truallit dhe lidhja e kontratës së blerjes nga Bashkia Sarandë është bërë më datë 04.11.2003, dy vjet pasi subjekti kishte paguar plotësisht çmimin e apartamentit në Tiranë.

15.6. Në këto kushte, rezulton se dy trojet në Sarandë, me sip. 314 m² dhe sip. 662 m², janë blerë e më pas janë shitur nga subjekti i rivlerësimit pas përfundimit të pagesave të apartamentit në Tiranë, situatë e cila pamundëson objektivisht përdorimin e fondeve të siguruar nga shitja e tyre, si burim të ardhurash për financimin e apartamentit në Tiranë, për të cilin pagesat kanë përfunduar përpara blerjes dhe shitjes së tyre.

15.7. Për sa i përket pretendimit të subjektit se ka përfituar vlerat e siguruar nga shitja e dy trojeve në Sarandë, përpara se ato të shiteshin formalisht, pra edhe para realizimit të pagesave të apartamentit në Tiranë, rezulton se jo vetëm që nuk mbështet nga asnjë dokumentacion shkresor, por duket se vjen dukshëm në kundërshtim me të gjitha të dhënat dhe informacionin që ofrojnë kontratat e blerjes/përfitimit të këtyre pasurive nga subjekti, si dhe të shitjes së tyre prej tij. Në këto rrethana, vlerësohet si jorelevante analiza lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për vlerat e përfituara prej shitjes së tyre, sa kohë që realizimi i të ardhurave ka ndodhur në kohë pas pagimit të çmimit të apartamentit në Tiranë dhe qëndrimi lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nuk do të afektonte gjithsesi analizën financiare për burimet e financimit të këtij apartamenti. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë në mesin e burimeve të financimit të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të përfituara nga shitja e dy trojeve në Sarandë, është i mbështetur në prova dhe, si i tillë, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

16. *Në vijim, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat ai kundërshton si jo të drejtë konkluzionet e vendimit të Komisionit se ka fshehur në deklaratën vetting, si dhe në deklaratimet periodike vjetore, ndërtimin e një objekti me sip. 110 m² në vitin*

2003 në Sarandë; dhe se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit me sip. 110 m², për të cilat konstaton dhe analizon sa vijon.

16.1. Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është analizuar, ndër të tjera, edhe situata faktike që ka rezultuar nga hetimi administrativ lidhur me konstatimin se mbi truallin prej 662 m², duket se është ndërtuar një objekt me sipërfaqe prej 110 m², i cili ka qenë gjithashtu objekt i shitjes në kontratën e shitblerjes së lidhur për shitjen e truallit. Në këtë analizë, Komisioni ka konstatuar disa fakte të cilat i ka vlerësuar se vendosin subjektin në kushtet e fshehjes së kësaj pasurie, mbështetur në analizën si më poshtë.

i. Me vendimin nr. {***}, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, subjektit i është dhënë si investitor sheshi i ndërtimit, blloku {***}, parcela nr. {***}, sipërfaqja 662 m².

ii. Në datën 1.11.2003, është mbajtur procesverbali i piketimit.

iii. Në datën 3.11.2003, subjekti ka paguar shumën 105.800 lekë, si pagesë për leje ndërtimi.

iv. Me vendimin e KRRT-së nr. {***}, datë 10.9.2003, është lëshuar leja e ndërtimit me subjekt ndërtues "{***}" (kjo shoqëri, bazuar në shkresën e QKB-së nr. {***}, datë 3.2.2020, ka pasur për administrator dhe ortak të vetëm z. M. L., babai i subjektit të rivlerësimit), me objekt banesë, blloku {***}, parcela nr. {***}; objekti financohet nga z. Artan Lulaj.

v. Në datën 10.12.2003, është lëshuar leja e shfrytëzimit për objektin "banesë vetjake" në zonën {***}, firma zbatuese "{***}", investitor Artan Lulaj. Sipas kësaj leje, objekti banesë vetjake, investitor Artan Lulaj, është i gatshëm për t'u vënë në shfrytëzim.

vi. Në datën 24.1.2004, subjekti, me kontratën nr. {***}, ka shitur sipërfaqe trualli 662 m² dhe objekt njëkatësh ndërtuar mbi këtë truall, me sipërfaqe 110 m², në vlerën 1.324.000 lekë. Bashkëlidhur gjendet dhe vërtetimi nga dokumenti hipotekor i datës 22.1.2004, sipas të cilit subjekti ka pasur të regjistruar pasurinë me sipërfaqe 662 m², si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m², ndërtuar në këtë truall. Subjekti, te të dhënat konfidenciale në deklaratën "vetting", ka deklaruar vetëm shitjen e truallit, ndërkohë që nuk ka deklaruar faktin që mbi këtë truall ishte ndërtuar një objekt me sipërfaqe 110 m². [...].vii. Subjekti, gjatë hetimit, ka refuzuar të deklarojë vlerën e investimit për objektin me sipërfaqe 110 m², si dhe të japë shpjegime të hollësishme në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, veprim i cili nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka kryer llogaritjen e ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m², bazuar në vlerën e kostos së ndërtimit për qytetin e Sarandës nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003, në shumën 23.121 lekë/m². Shuma e investimit për këtë pasuri rezulton në vlerën 2.544.410 lekë (110 m² x 23.121 lekë).

Në kushtet kur subjekti ka refuzuar të deklarojë burimin e ligjshëm të të ardhurave për banesën me sipërfaqe 110 m², Komisioni ka kryer një analizë financiare, bazuar në të dhënat e administruara për vitin 2003 nga hetimi administrativ. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 1.300.405,92 lekë, për të ndërtuar banesën me sipërfaqe 110 m². Subjektit iu kalua barra e provës për këtë mungesë të ardhurash. [...]

viii. Në përfundim, Komisioni çmon se në lidhje me truallin dhe objektin me sipërfaqe 110 m², gjendemi në kushtet e fshehjes së pasurisë në deklaratat periodike, por edhe në deklaratën "vetting", si dhe subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit me sipërfaqe 110 m². Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë,

të paplotë dhe të pamjaftueshëm, si dhe fshehje të pasurisë, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “b” dhe “c” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

16.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me këtë qëndrim të Komisionit, ka paraqitur të njëjtat argumente me ato të dhëna prej tij në shpjegimet për rezultatet paraprake të hetimit administrativ, duke pretenduar se për sa i përket ndërtimit të objektit me sip. 110 m² në truallin me sip. 662 m², ai i ka kaluar palës blerëse të drejtat e pronësisë që në vitin 2000, dhe se vetë çmimi i vogël i shitjes tregon se investimi nuk është kryer nga subjekti, por nga pala blerëse.

16.3. Lidhur me këto pretendime të subjektit, nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për objektin me sip. 110 m², në disa akte me karakter ligjor dhe tekniko-administrativ¹⁹ të krijuara nga organe publike, si Bashkia Sarandë, figuron si investitor dhe në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të ZRVPP Sarandë, figuron edhe pronar i këtij objekti.

16.4. Në analizë të akteve të mësipërme, të deklaratës *vetting* dhe deklarimeve periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se:

Së pari, në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk e kishte në pronësi objektin me sip. 110 m² të ndërtuar në truallin me sip. 662 m² në Sarandë, pasi, sipas të dhënave të kontratave noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., këtë objekt dhe truallin i kishte shitur më datë 24.1.2004.

Së dyti, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se: **(i)** subjekti në asnjë deklaram periodik vjetor nuk ka deklaruar pronësinë mbi ndërtimin 110 m² në Sarandë, edhe pse sipas dokumentit hipotekor, rezulton se më datë 22.1.2004, subjekti ka pasur të regjistruar në pronësi të tij pasurinë me sipërfaqe 662 m², si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m², ndërtuar mbi të; **(ii)** në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm shitjen e truallit 662 m² në Sarandë dhe jo të objektit 1-katësh 110 m² që ndodhej në të,

¹⁹ Konkretisht, aktet që evidentojnë këto të dhëna janë sa vijojnë.

- Me vendimin nr. {***}, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak Sarandë, subjektit i është dhënë si investitor sheshi i ndërtimit, blloku {***}, parcela nr. {***}, sipërfaqja 662 m². Në datën 1.11.2003, është mbajtur procesverbali i piketimit.
- Në datën 3.11.2003, subjekti ka paguar shumën 105.800 lekë, si pagesë për leje ndërtimi.
- Me vendimin e KRRT-së nr. {***}, datë 10.9.2003, është lëshuar leja e ndërtimit me subjekt ndërtues “{***}” (kjo shoqëri, bazuar në shkresën e QKB-së nr. {***}, datë 3.2.2020, ka pasur për administrator dhe ortak të vetëm z. M. L., babai i subjektit të rivlerësimit), me objekt banesë, blloku {***}, parcela nr. {***}; objekti financohet nga z. Artan Lulaj.
- Leja e shfrytëzimit e lëshuar më datë 10.12.2003 për objektin “banesë vetjake” në zonën {***}, firma zbatuese “{***}”, investitor Artan Lulaj. Sipas kësaj leje, objekti banesë vetjake, investitor Artan Lulaj, është i gatshëm për t’u vënë në shfrytëzim.
- Në datën 24.1.2004, subjekti i rivlerësimit, me kontratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., ka shitur sipërfaqe truall 662 m² dhe objekt 1- (një-) katësh ndërtuar mbi këtë truall, me sipërfaqe 110 m², në vlerën 1.324.000 lekë. Bashkëlidhur kontratës së shitjes, në praktikën e përcjellë nga ASHK Vendore Sarandë në ILDKPKI më date 03.01.2017, gjendet dhe vërtetimi nga dokumenti hipotekor i datës 22.1.2004, sipas të cilit subjekti ka pasur të regjistruar pasurinë me sipërfaqe 662 m², si dhe një objekt njëkatësh me sipërfaqe 110 m², ndërtuar në këtë truall. Subjekti, te të dhënat konfidenciale në deklaratën “vetting”, ka deklaruar vetëm shitjen e truallit, ndërkohë që nuk ka deklaruar faktin që mbi këtë truall ishte ndërtuar një objekt me sipërfaqe 110 m².

duke deklaruar se nuk disponon të dhëna pasi kontrata e shitjes së objektit nuk gjendej, ndërsa nga praktika e përcjellë nga ASHK Vendore Sarandë në ILDKPI, me nr. {***} prot., datë 03.10.2017, gjendet e administruar kontrata noteriale e shitjes së truallit me sip. 662 m² dhe e objektit njëkatësh me sip. 110 m², me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 24.01.2004; (iii) faktin se gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka mundur të paraqesë ndonjë akt apo të dhënë të kohës që dëshmon për financimin e këtij ndërtimi nga palë të treta dhe jo prej tij; (iv) analiza financiare e kryer në Komision dhe në Kolegj konfirmon se subjekti ishte në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në shumën (-) 1.300.406 lekë për të financuar ndërtimin e objektit 1 kat me sip. 110 m², kostot e ndërtimit të të cilit, duke aplikuar vlerën e kostos së ndërtimit të publikuar nga Enti Kombëtar i Banesave²⁰ për qytetin e Sarandës, rezultojnë të kenë qenë 2.544.410 lekë.

16.5. Bazuar në elementet e mësipërme, trupi gjykues në tërësi vlerëson se kjo situatë, në referim edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit²¹, ndonëse ka në përbërje të saj si elemente të mosdeklarimit të të drejtave mbi këtë pasuri, siç figuron nga aktet, apo edhe të mosdeklarimit të ndonjë shpenzimi të kryer për ndërtimin e këtij objekti, duket se nuk mbështet konkluzionin e Komisionit se jemi para një rasti që mund të klasifikohet si “fshehje e pasurisë”, për sa kohë që në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*, subjekti e kishte humbur tashmë pronësinë mbi këtë objekt nëpërmjet shitjes së tij që në vitin 2004. Vlerësimi i trupit gjykues në këtë linjë lidhet me interpretimin ligjor të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, situatat faktike që mund të kualifikohen sipas këtyre dispozitave, duhet të gjejnë pasqyrim në deklaratën *vetting*, si objekti i kontrollit të vërtetësisë së deklarimeve për efekt të procesit të rivlerësimit.

²⁰ Kolegji, ashtu si dhe Komisioni, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar vlerën e investimit për objektin me sipërfaqe 110 m², ka përllogaritur vlerën e kostos së këtij ndërtimi bazuar në vlerën e kostos së ndërtimit për qytetin e Sarandës nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2003, në vlerën 2.544.410 lekë (110 m² x 23.131 lekë/m²). Shih: <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2003/>.

²¹ Në vendimin e Kolegjit (JR) 52/2023, në paragrafin 16.2, për një situatë të ngjashme, nga trupi gjykues është arsyetuar si vijon:

“[...] Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë “vetting”, lidhur me marrëdhënien e tij me këtë pasuri, si të përfituar nëpërmjet kontratës së cedimit të të drejtave në vitin 2016, vlerësohen në këtë kontekst si të pavërteta, qoftë për mënyrën e fitimit të pronësisë, kohën e lindjes së kësaj marrëdhënieje dhe pagesës së çmimit për të. Trupi gjykues çmoi se situata faktike e pretenduar prej Komisioneres Publike, lidhur me marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri dhe e konfirmuar edhe prej analizës së bërë në këtë vendim, duket të kualifikohet në një parashikim të ndryshëm ligjor, duke qenë se konsiderimi i saj si një pasuri e fshehur rezulton të jetë jo i saktë, në kushtet kur subjekti ka deklaruar në deklaratën “vetting” të drejtat e pronësisë që ai gëzon në këtë pasuri, si dhe e ka vendosur atë në dispozicion të kontrollit të organeve të rivlerësimit. Për pasojë, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk do të gjente vend zbatimi i nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila do të kualifikonte situatën në të cilën në deklaratën “vetting” subjekti do të kishte heshtur për ekzistencën e marrëdhënies së tij me këtë pasuri, duke synuar shmangien e kontrollit të organeve të rivlerësimit për të. Pavarësisht këtij konkluzioni, duke qenë se situata e paligjshmërisë rreth deklarimeve të subjektit të rivlerësimit qëndron, siç u arsyetua më lart, trupi gjykues, duke përdorur të drejtën e tij për të kualifikuar saktë faktet, sipas përcaktimit të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se ato duhen konsideruar si të pavërteta e të rreme me synim deformimin e rezultateve të kontrollit që do ushtrohet mbi këtë pasuri prej organeve të rivlerësimit në drejtim të burimeve për krijimin e saj, të cilat rezultojnë se kanë munguar në kohën e krijimit të pasurisë, në vitin 2003”.

16.6. Për sa më sipër, trupi gjykues i vlerësoi deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* lidhur me këtë pasuri, në raport me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe çmoi se ato përmbajnë të dhëna të pavërteta, të cilat konfirmohen si të tilla nga aktet e administruara gjatë hetimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, të ardhura të krijuara nga shitja e pasurisë truall me sipërfaqe 662 m², ndërsa nga kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie, e administruar gjatë hetimit, rezulton se subjekti nuk ka shitur vetëm truallin, por edhe objektin njëkatësh mbi të, me të njëjtën kontratë, objekt për ekzistencën/ndërtimin e të cilit nuk ka bërë asnjëherë asnjë deklaram në vite. Përveç sa më sipër, rezulton se subjekti, nën përgjegjësinë për deklarime të vërteta, ka deklaruar në deklaratën *vetting* se ai nuk disponon të dhëna për këtë pasuri, pasi nuk gjendet dokumenti, ndërsa ka rezultuar se kontrata e shitblerjes, si edhe objekti njëkatësh në pronësi të subjektit para shitjes, figuronin të regjistruara në regjistrin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në ZVRPP Sarandë, për pasojë lehtësisht të evidentueshme dhe të administrueshme. Kjo situatë, krahas shpjegimeve të mëposhme të subjektit, se ndërtimi është kryer prej blerësve të truallit, ndërsa leja e ndërtimit rezulton të jetë lëshuar për subjektin ndërtues “{***}” ShPK, që i përket babait të subjektit, dhe më pas është regjistruar në pronësi të vetë subjektit, dëshmojnë për përpjekje të tij për të deklaruar fakte të pavërteta në deklaratën *vetting*, me qëllim shmangien nga hetimi administrativ i një pasurie për të cilën subjekti jo vetëm që nuk kishte bërë asnjë deklaram në vite, por që sipas analizës financiare të kryer, rezulton se nuk kishte pasur burime të ligjshme për ta krijuar. Pretendimet e tij se vlera e ulët e shitjes së truallit në të cilin është ndërtuar objekti, tregon se objekti nuk është ndërtuar prej tij, mbeten deklarative dhe jobindëse, përderisa në shumë raste të tjera, pretendohet se vlerat e çmimeve të përcaktuara në kontrata nuk i përgjigjen realitetit, por një dakordësie mes palëve që duket se ka synuar përgjithësisht uljen e vlerës së detyrimit tatimor për t’u paguar.

16.7. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se deklarimi nga subjekti i rivlerësimit i të dhënave të pavërteta lidhur me shitjen e pasurisë, objekt me sipërfaqe 110 m², dhe dokumentimin e saj në deklaratën *vetting*, vlerësuar në harmoni me mosdeklarimet e tij në deklaramin fillestar të vitit 2003, atë periodik të vitit 2004, është një situatë e cila e vendos subjektin në kushtet e një deklarimi të rremë, të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

17. Në konsideratë të pretendimeve të subjektit, me të cilat ai kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar ligjërish analizën e kryer nga Komisioni në dy versione²², duke pretenduar që kjo analizë të bëhet duke u mbështetur në deklaramet e bëra për burimet e financimit në deklaratën *vetting*, trupi gjykues vlerëson se:

17.1. Në kushtet kur në procesin e rivlerësimit kalimtar, në zbatim të kërkesave të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë fillon me deklaratën sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, të quajtur ndryshe si “deklarata *vetting*”, në të cilën, për

²² Sipas vendimit të Komisionit, pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamenti në Tiranë, ka rezultuar: a) në vlerën (-) 5.828.550 lekë në versionin që pranohet se burimet e blerjes së apartamentit në Tiranë janë sipas atyre të deklaruara nga subjekti në DPV fillestare 2003; b) në vlerën (-) 1.386.608 lekë, nëse u referohemi deklarameve të bëra nga subjekti mbi burimet e financimit të apartamentit në Tiranë në deklaratën “*vetting*”, tek e cila, në ndryshim nga deklaramet e bëra në DPV fillestare 2003, për apartamentin në Tiranë, ka shtuar si burime financimi edhe të ardhurat e siguruar nga aktiviteti si noter deri në vitin 2000.

apartamentin në Tiranë, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se si burim financimi kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga aktiviteti si noter, versioni i drejtë i analizës financiare i cili është aplikuar si i tillë në Kolegj, është ai i bazuar në deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting*, tek i cili janë përfshirë të ardhurat nga noteria, për të cilat, siç është arsyetuar më lart, nga dokumentacioni i administruar, provohet qarkullimi vjetor, si dhe pagesa e detyrimeve tatimore. Ky qëndrim lidhet jo vetëm me faktin që në kuptimin formal subjekti i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën *vetting*, si burim krijimi të pasurisë, por edhe sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mbështetur në parimin e objektivitetit, se duket logjike që subjekti të ketë përdorur të ardhurat nga aktiviteti i tij si noter, i ushtruar deri në vitin 2000, për të financuar blerjen e një apartamenti në vitin 2001, sa kohë që nuk rezultojnë investime të tjera të rëndësishme të subjektit para atij objekt kontrolli.

17.2. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me burimet e financimit të apartamentit në Tiranë, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë pasuri, duke reflektuar konkluzionet e mësipërme, konkretisht: **(i)** të ardhurat e siguruara nga subjekti prej shitjes së apartamentit në Sarandë, për shkak të kohës kur është realizuar shitja e kësaj pasurie janë llogaritur si burim për të financuar vetëm pagesën e fundit të apartamentit në Tiranë, në shumën 5.000 USD; **(ii)** vlerat e pretenduara nga subjekti si të përfituara nga shitja e dy trojeve në Sarandë, me sip. 314 m² dhe sip. 662 m², nuk janë konsideruar si burime financimi për pagesat e apartamentit në Tiranë, për shkak se nga akte me vlerë të plotë provuese, siç janë kontratat e blerjes dhe shitjes së dy trojeve, rezulton se janë shitje pasurish të realizuara pas datës 14.11.2001, kur ka përfunduar pagesa e apartamentit në Tiranë; **(iii)** lidhur me të ardhurat e siguruara nga aktiviteti si noter i subjektit, u përfshinë të ardhurat vetëm për vitet që administrata tatimore konfirmon qarkullimin, mbi të cilin është aplikuar marzhi i fitimit aq sa e ka përlllogaritur Komisioni dhe pranuar edhe subjekti përgjatë hetimit administrativ dhe në ankim, në masën 75% të qarkullimit vjetor.

17.3. Nga analiza financiare e kryer sipas të dhënave të mësipërme, trupi gjykues konstatoi se deri më datë 14.11.2001, kur subjekti i rivlerësimit ka përfunduar pagesat e apartamentit në Tiranë, ishte në pamundësi financiare për të përballuar investimet dhe shpenzimet e jetesës, për një vlerë prej (-) 703.859 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se për pasurinë apartament banimi me sip. 117 m², në rrugën “{****}”, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në vitin 2001, ka qenë me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe të mbulimit të kostove të jetesës, situatë e cila e vendos atë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

18. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, me të cilin kundërshton si të padrejtë dhe të bazuar ligjërisht konkluzionin e Komisionit se *nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën (-) 958.831 lekë, për rikonstruksionin dhe mobilimin e apartamentit në Tiranë në vitin 2014, duke kërkuar rillogaritje nga Kolegji në mënyrë objektive dhe të drejtë për këtë element të analizës financiare.* Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, konstatohet dhe analizohet sa vijon.

18.1. Komisioni ka ushtruar kontroll lidhur me shpenzimin prej subjektit të një shume prej 2.000.000 lekësh në vitin 2014, e përdorur për rikonstruksionin e apartamentit të ndodhur në

Tiranë e të analizuar më sipër. *A prima facie*, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar shpenzimin e kësaj shume në DPV-në e vitit 2014 dhe as në deklaratën *vetting*, dhe se për herë të parë e ka deklaruar atë gjatë hetimit administrativ. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet për pyetësin nr. 3, ka deklaruar se punimet kanë filluar në fund të muajit gusht dhe kanë përfunduar në mesin e muajit shtator 2014 dhe si burim për rikonstruksionin e këtij apartamenti, ka deklaruar se ka përdorur likuiditete të tërhequra nga llogaria bankare e bashkëshortes së tij pranë Bankës Tirana. Komisionit i ka rezultuar se deri më datë 17.09.2014, bashkëshortja ka kryer dy tërheqje nga llogaria e saj, në vlerën totale 650.000 lekë dhe tërheqja tjetër është kryer më datë 27.10.2014, në vlerën 1.999.820 lekë. Komisioni ka vlerësuar se shuma e tërhequr nga bashkëshortja e subjektit më datë 27.10.2014, nuk mund të ketë shërbyer si burim për kryerjen e pagesave për rikonstruksionin e apartamentit pasi, referuar deklarimeve të subjektit, rikonstruksioni i apartamentit ka përfunduar më datë 17.09.2014²³, punimet janë kryer pjesë-pjesë, pagesat janë kryer *cash* dhe për këto pagesa nuk është dorëzuar dokumentacion dhe as është pretenduar se janë paguar pas përfundimit të rikonstruksionit. Nga analiza e kryer mbi konsideratat e mësipërme, Komisioni ka konkluduar se subjekti në vitin 2014, ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 958.831 lekë për të kryer rikonstruksionin dhe mobilimin e apartamentit në Tiranë.

18.2. Subjekti, me ankimin, kundërshton analizën e mësipërme të kryer nga Komisioni, dhe pretendon se në asnjë rast nuk ka deklaruar datë të përcaktuar të përfundimit të rikonstruksionit, por edhe në rast se do të merrej e mirëqenë data 17.09.2014 e vendosur nga Komisioni, nuk mund të caktohet një e tillë për përfundimin e mobilimit dhe blerjes së orendive elektro-shtëpiake. Subjekti pretendon se pagesat për rikonstruksionin e apartamentit janë kryer gjatë dhe pas përfundimit të punimeve, dhe kjo vërtetohet me tërheqjen e depozitës me përshkrimin “Para afatit të maturimit për rikonstruksion shtëpie” më datë 28.08.2014, pranë Tirana Bank, në vlerën 3.050.000 lekë. Me ankimin, subjekti kundërshton si të pabazuar analizën financiare të bërë për rikonstruksionin e apartamentit, duke e shtrirë atë deri më datë 17.09.2014 dhe jo përtej kësaj date.

18.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e subjektit të kryera në momente të ndryshme për sa i përket këtij investimi, nga e cila i rezultuan disa të dhëna të rëndësishme për çështjen. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* ka deklaruar: “Shpenzime për rindarje të brendshme të apartamentit prej 117 m², të kryera në vitin 2001, në shumën 2.000.000 lekë”, dhe nuk rezulton të ketë bërë ndonjë deklaram për shpenzimet e kryera në apartament në vitin 2014. Këtë të dhënë subjekti nuk e ka deklaruar as në DPV-në e vitit 2014, por e ka përcjellë këtë deklaram vetëm gjatë rezultateve të hetimit si shpenzim të kryer në vitin 2014. Përpos këtij deklarimi, shpenzimet e kryera për këtë qëllim rezultojnë të evidentohen nga dokumentacioni bankar i administruar prej Komisionit e që lidhet me tërheqjen që bashkëshortja e subjektit ka kryer në llogarinë e saj bankare në Bankën Tirana, si më sipër cituar.

18.4. Në mënyrë të detajuar, gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti, lidhur me këto shpenzime, të ketë deklaruar sa vijon: **(i)** në pyetësin standard, për pyetjen nr. 9, ka shpjeguar

²³ Kjo datë është përcaktuar nga Komisioni duke iu referuar përgjigjes së dhënë nga subjekti për pyetësin nr. 2, se punimet kanë përfunduar në mesin e muajit shtator 2014.

se: Po, kam pasur shpenzime më të larta se 2.500 euro, për shkak se ka qenë e nevojshme të investoja në përmirësimin e kushteve të banesës familjare. Këto shpenzime janë kryer në muajt korrik-tetor të vitit 2014. Kostot janë mbuluar nga të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Apelit nr. {***}, datë 16.07.2010, me objekt “Kthim në punë dhe dëmshpërblim”. Mënyra e pagesës ka qenë CASH, e shtrirë gjatë gjithë periudhës; (ii) në përgjigjet për pyetësonin nr. 1, subjekti ka deklaruar se: në vitin 2014 ka shpenzuar shumën 2.000.000 lekë për rindarje të apartamentit, për shkak të nevojës së krijimit të kushteve më optimale, pasi fëmijët ishin të rritur dhe në prag punësimi. Duke qenë se babai im, ka qenë me profesion inxhinier ndërtimi, drejtimi i punimeve, si dhe kontaktet me subjektet ndërtuese janë kryer prej tij. Shuma e këtyre punimeve është në vlerën e 2.000.000 lekë; (iii) në përgjigjet për pyetësonin nr. 2, subjekti ka deklaruar se: Rindarja e apartamentit me sipërfaqe 117 m², blerë në 2001, është bërë në vitin 2014, provuar kjo nga leja për kryerjen e punimeve e lëshuar nga Njësia Administrative nr. 2, Tiranë, si dhe nga transferimi i fondit nga llogari depozite në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së tij, në Tirana Bank ShA, ku pasqyrohet qartë qëllimi i transferimit (rikonstruktion shtëpie). Subjekti ka depozituar edhe një preventiv në format A4 të pafirmosur, në vlerën totale 1.971.960 lekë; (iv) në përgjigjet për pyetësonin nr. 3, i pyetur në lidhje me kohëzgjatjen e punimeve, subjekti ka deklaruar se: Informoj se punimet për rikonstrukcionin e banesës kanë zgjatur një muaj, kanë nisur në fund të muajit gusht dhe kanë vazhduar deri në mes të muajit shtator të vitit 2014, pasi leja për rikonstrukcionin e banesës është lëshuar nga Sektori i Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban të Njesisë Bashkiake nr. 2, pranë Bashkisë Tiranë më datë 28.08.2014; (v) në ILDKPKI, sipas informacionit që ofron procesverbali i datës 03.03.2016, subjekti ka deklaruar se: [...] kam deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit në vlerën 3.500.000 lekë, nga të cilat 1.500.000 lekë janë shpenzuar për arredimin e shtëpisë në Tiranë dhe pjesa tjetër janë kursime.

18.5. Nga analiza e deklarimeve të mësipërme, rezulton se subjekti duket se ka qëndrueshmëri në drejtim të kohës kur janë kryer punimet për rikonstrukcionin e banesës, në periudhën gusht deri në mesin e muajit shtator, deklarime të cilat, në mungesë të deklaramit në DPV-në e vitit 2014, duhen analizuar në harmoni edhe me të dhënat e tjera që rezultojnë nga hetimi. Në këtë kontekst, duket se deklaramet për kohën e kryerjes së punimeve mbështeten nga leja për rikonstrukcion e lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. 2 Tiranë, e datës 28.08.2014, transferimi i fondeve të gjendura në llogarinë depozitë të bashkëshortes, në llogarinë rrjedhëse po në Tirana Bank, me përshkrimin “Para afatit të maturimit për rikonstrukcion shtëpie” në datën 28.08.2014, të dhëna të cilat duket se mbështesin deklaramin se punimet kanë filluar të paktën në gusht dhe kanë përfunduar në kohën që subjekti ka përcaktuar si tillë, në mesin e shtatorit 2014. Në këtë kontekst, ndonëse subjekti rezulton se nuk ka bërë deklaramet të sakta në DPV-në e vitit 2014 rreth këtij investimi, të cilat mund të jepnin të dhëna më të sigurta për kohën e kryerjes së tij, si edhe vlerat respektive të shpenzuara, trupi gjykues, në mungesë të ndonjë të dhëne që përcakton një rrethanë të ndryshme fakti nga sa ka deklaruar subjekti, e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit është konkluduar se punimet për rikonstrukcionin e apartamentit kanë përfunduar në mesin e muajit shtator dhe, si të tilla, ato i janë ngarkuar si shpenzim analizës financiare të subjektit për këtë vit, deri në datën 17.09.2014, për një vlerë totale prej 2.000.000 lekësh, duke përdorur si burim për mbulimin e tyre nga llogaria bankare e bashkëshortes vetëm shumën prej 650.000 lekësh të tërhequr para kësaj date.

18.6. Në ndryshim nga sa ka arsyetuar Komisioni, trupi gjykues, duke përdorur të njëjtën linjë arsyetimi mbi vlerën që marrin deklaratimet e subjektit në mungesë të të dhënave që provojnë të kundërtën e tyre, vlerësoi se shpenzimet për mobilimin e apartamentit në vlerën prej 1.400.000 lekësh, të deklaruara si të tilla edhe në DPV-në e vitit 2014, duhen konsideruar si një shpenzim vjetor dhe jo të lidhura posaçërisht me datën e prezumuar për përfundimin e punimeve. Në ndryshim nga deklaratimet për shpenzimet për rikonstruksionin, për të cilat trupi gjykues iu referua shpjegimeve të subjektit në pyetësor, lidhur me shpenzimet për mobilimin, trupi gjykues vlerëson se duhet të referohet në deklaratimet e bëra në DPV-2014, duke i shtrirë ato deri në fund të vitit, ndërsa e konsideron të padrejtë qëndrimin e Komisionit i cili i vendos ato në të njëjtën datë me ato të rikonstruksionit, për sa kohë asnjë deklaratim i subjektit dhe asnjë dokument ligjor nuk e mbështet këtë qëndrim. Në këtë mënyrë, të ardhurat e përfituara nga tërheqjet në llogarinë e bashkëshortes deri në fund të vitit²⁴, krahas të ardhurave të tjera të njësisë familjare, janë përfshirë në analizën financiare për të kontrolluar mundësinë e subjektit për kryerjen e këtyre shpenzimeve me burime të ligjshme.

18.7. Duke reflektuar konkluzionet e mësipërme në analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me shpenzimet për rikonstruksionin e apartamentit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të kryer këtë shpenzimin deri në datën 17.09.2014.

- 19.** *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është i padrejtë dhe i pabazuar ligjërisht konkluzioni i Komisionit se nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të realizuar pagesën e kështit të dytë të apartamentit me sip. 60 m² në lagjen {***}, Plazh, Durrës, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.*

19.1. Në vendimin e Komisionit për apartamentin me sip. 60 m² në lagjen {***}, Plazh, Durrës, është konkluduar se:

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se në lidhje me kohën e pagesës së shumës 5.000 euro, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për kryerjen e kësaj pagese në vitet 2010-2011. Deklarata noteriale e z. N. është thjesht në nivel deklarativ dhe është një dokument i hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe fuqia e saj provuese, bazuar dhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, merret me rezerva. Komisioni, referuar deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike që përbëjnë provë, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe përmbajtjes së kontratës së shitblerjes, do të konsiderojë që kësti i dytë në shumën 5.000 euro është paguar para lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2009.

Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të financuar pagesën e kështit të dytë, në shumën 501.986,91 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaratim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në

²⁴ Lëvizjet bankare japin informacionin si vijon:

- Më datë 21.08.2014, është prishur depozita në shumën 3.050.000 lekë, me përshkrim "Para afatit të maturimit për rikonstruksion shtëpie".
- Më datë 22.08.2014, është tërhequr shuma 500.000 lekë.
- Më datë 17.09.2014, është tërhequr shuma 150.000 lekë.
- Më datë 27.10.2014, është tërhequr shuma 1.999.820 lekë.

kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni vlerëson se, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

19.2. Me ankimin, ashtu siç ka shpjeguar edhe në Komision, subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë qëndrim të Komisionit duke pretenduar se:

Lidhur me konkluzionin e Komisionit, ripërsëris atë çfarë është e vërtetë, dhe e vetme, se lidhur me vlerën e mbetur të këtij apartamenti, në shumën 5.000 (pesë mijë) euro, kjo shumë është paguar nga ana ime gjatë viteve 2010, 2011. Kjo diferencë, sikundër vërtetohet qartësisht edhe nga deklarimi i administratorit të shoqërisë ndërtuese, është paguar në cash në shumat 2.500 euro në vitin 2010 dhe 2.868 në euro në vitin 2011. Këto shuma janë paguar pikërisht në këto vite, pra në vitin 2010 dhe në vitin 2011, pavarësisht mosdeklarimit të këtij detyrimi të mbartur që prej vitit 2006. Mosdeklarimi im në vitin 2009, lidhet me faktin se kemi menduar që ky detyrim është deklaruar vitet e mëparshme. [...]

19.3. Për shqyrtimin e këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e bëra për apartamentin në Plazh, Durrës, nga subjekti në deklaratën *vetting*²⁵, si dhe në deklaratimet periodike vjetore²⁶.

Në referim të informacionit që ofrojnë deklaratimet e bëra nga subjekti për këtë pasuri, duke konsideruar se kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.5.2009, përcakton se shuma 40.000 euro është likuiduar plotësisht nga subjekti, si dhe duke konstatuar faktin se në DPV-2009, subjekti nuk ka deklaruar se ka ende detyrim të pashlyer ndaj shoqërisë së ndërtimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka vlerësuar se pagesa e kështit prej 5000 eurosh është kryer nga subjekti para lidhjes së kontratës së shitblerjes në shkurt 2009. Nga analiza e kryer prej Komisionit sipas këtij vlerësimi, ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së kështit të fundit të apartamentit në shumën 5.000 euro, në vitin 2009. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë analizë të Komisionit duke pretenduar se detyrimi prej 5.000 eurosh është paguar prej tij

²⁵ Në deklaratën “vetting”, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi me sipërfaqe 60 m², ndodhur në lagjen nr. {***} (Plazh), Durrës. Vlera e apartamentit: 40.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Blerë me kredi nga Alfa Bank, dhe kursime nga të ardhurat (shih te konfidenciali)”. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Kontratë kredie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.11.2006, me vlerë 30.000 euro, për banesën 60 m.²”

²⁶ Në deklaratimet periodike vjetore (referuar si “DPV”), subjekti ka deklaruar:

- i. Në DPV-2006, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi, pa regjistruar (prenotuar) me sipërfaqe 70 m², ndodhur te zona e “Shkëmbit të Kavajës”. Vlera: 40.000 euro. Pjesa takuese: 50%”. Subjekti nuk ka deklaruar burim për krijimin e kësaj pasurie. Në këtë DPV, subjekti ka deklaruar: “Detyrim ndaj investitorit të firmës “{***}” ShPK : 10.000 euro. Shlyer 5.000 euro nga kursimet e të ardhurave”.
- ii. Në DPV-2007, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “Detyrimi ndaj shoqërisë ndërtuese i mbetur i pashlyer gjatë vitit 2007, në vlerën 5.000 euro”.
- iii. Në DPV-2008, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: “Detyrimi ndaj shoqërisë ndërtuese i mbetur i pashlyer që nga vitit 2007, në vlerën 5.000 euro”.
- iv. Në DPV-2009, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi i ndodhur në zonën e plazhit Durrës, deklaruar në deklarinim e vitit 2008, është regjistruar në ZRVP Durrës, zona kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}.”

me pagesat respektive, në shumën 2.500 euro të kryer në vitin 2010 dhe po aq të paguar në vitin vijues, 2011.

19.4. Trupi gjykues konstaton se ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit, i mbajtur në Komision dhe i përsëritur në ankim, synon të spostojë pagesën e këstit të fundit të çmimit të apartamentit, nga viti 2009 në vitet 2010 dhe 2011, kur analiza e tij financiare është e favorshme. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti kërkon nga Kolegji të konsiderohet përmbajtja e deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.2021, e z. A. N., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, e paraqitur prej tij në Komision, tek e cila ai konfirmon shpjegimet e mësipërme të subjektit duke deklaruar se shuma 5.000 euro është shlyer nga subjekti përkatësisht 2.500 euro në vitin 2010 dhe po aq në vitin 2011. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se moskonsiderimi prej Komisionit i deklaratimeve të dhëna në deklaratën noteriale të z. A. N., është një standard i dyfishtë i aplikuar nga ky organ në vlerësimin e deklaratave noteriale të kryera gjatë procesit të rivlerësimit, pasi në raste të tjera të ngjashme, i ka pranuar ato, kurse në rastin e tij, preferon të mos i marrë parasysh, duke rënduar pozitën e tij.

19.5. Trupi gjykues, lidhur me këtë pretendim të subjektit, evidenton se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit²⁷ në shumë raste ka elaboruar gjerësisht qëndrimin se deklaratat noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, si të vetme, të pambështetura nga prova të tjera, kanë vlerë provuese të kufizuar. Përpos sa më sipër, trupi gjykues konstaton se në rastin konkret, me paraqitjen e deklaratës noteriale të dhënë nga z. N. më datë 17.09.2021, subjekti i rivlerësimit nuk kërkon të mbështesë një të dhënë apo indicet mëparshme, por ai pretendon që mbështetur në këto deklarime, të pranohet moszbatimi i përcaktimit të kontratës noteriale të shitblerjes së apartamentit në Plazh, Durrës, nr. {***}, të datës 14.05.2009, e cila, në nenin e emërtuar “Çmimi i shitjes”, përcakton se shuma 40.000 euro është likuiduar dhe apartamenti është marrë në dorëzim prej blerësit.

19.6. Në analizë të informacionit që ofrojnë aktet, nga njëra anë kontrata noteriale e shitblerjes së apartamentit në Plazh, Durrës, e cila përcakton se çmimi 40.000 euro është paguar plotësisht para datës 14.05.2009, dhe në anën tjetër, deklarata noteriale e lëshuar më datë 17.09.2021 nga administratori i shoqërisë (njëkohësisht nënshkruesi i kontratës së mësipërme, në cilësinë e palës shitëse), i cili ndryshe nga përcaktimet e kontratës së shitblerjes deklaroi se shuma 5.000 euro është paguar nga subjekti në vitet 2010 dhe 2011, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje vlerën e plotë provuese²⁸ të kontratës së shitblerjes lidhur me faktet e deklaruara në të, të cilat

²⁷ Për qëndrimet e mbajtura nga Kolegji lidhur me vlerën e deklaratave noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, referohuni në vendimet e Kolegjit: (JR) nr. 6/2018, për SR B. N.; (JR) nr. 7/2019, për SR E. S.; (JR) nr. 34/2019, për SR E. P.; (JR) nr. 2/2020, për SR B. C.; (JR) nr. 23/2020, për SR D. P.; (JR) nr. 24/2020, për SR F. E.; (JR) nr. 29/2020, për SR E. A.; (JR) nr. 33/2020, për SR D. S.; (JR) nr. 11/2021, për SR P. K.; (JR) nr. 12/2021, për SR A. M.; (JR) nr. 11/2022, për SR E. I.

²⁸ Në nenin 690 të Kodit Civil parashikohet se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”. Ndërsa në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

nuk mund të vihen në dyshim nga deklaratimet e palëve që kanë nënshkruar në të, në kohë të mëpashme e në kontekst të procesit të rivlerësimit.

19.7. Gjithashtu, trupi gjykues sjell në vëmendje edhe faktin se subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2009, nuk ka deklaruar ndonjë detyrim të mbartur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, deklaram që figuronte të ishte i vlefshëm sipas DPV-së së viteve 2006, 2007 dhe 2008, pikërisht për shumën prej 5000 eurosh. Këto të dhëna që vijnë nga deklaratat periodike të konsideruara si me cilësinë e provës në procesin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbështesin sa është deklaruar prej palëve në kontratën e shitblerjes së pasurisë, duke lënë pa vlerë provueset deklaratimet e administratorit të shoqërisë në deklaratën noteriale të vitit 2021 dhe shpjegimet/prendimet e subjektit lidhur me pagimin e kësaj shume në vitet 2010-2011.

19.8. Në konsideratë të këtij qëndrimi, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni për pasurinë objekt kontrolli, nga e cila rezultoi se Komisioni, në analizën financiare të kryer, ka përllogaritur gabim të ardhurat nga puna e subjektit, si dhe të ardhurat nga puna e bashkëshortes së tij. Komisioni i ka përllogaritur ato për 5 muaj, mbi totalin e të ardhurave të siguruara nga pagat e vitit 2009. Duke u nisur nga fakti që analiza financiare është kryer deri më datë 14.05.2009, trupi gjykues çmon se kjo e ardhur minimalisht duhet të ishte llogaritur për 4,5 muaj, pa marrë në konsideratë që paga e muajit maj është përfituar më 15.06.2009. Trupi gjykues konstaton se nëse përllogaritja e të ardhurave nga pagat e subjektit²⁹, si dhe të bashkëshortes së tij³⁰, do të bëhej duke iu referuar *statement*-eve respektive të llogarive bankare të pagave, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 674.780 lekë, për të paguar këstin me vlerë 5.000 euro, në vitin 2009.

19.9. Pavarësisht analizës së mësipërme, në konsideratë të garantimit të parimit *no reformatio in peius*, trupi gjykues konkludoi se shuma për të cilën, për efekt të analizës financiare, subjekti do të konsiderohet me mungesë të burimeve të ligjshme për të kryer pagesën e kështit në shumën 5.000 euro të apartamentit në Plazh, Durrës, do të jetë e njëjtë me vlerën e përcaktuar në analizën financiare të Komisionit, prej (-) 501.987 lekësh, duke e kualifikuar subjektin se gjendet në këtë mënyrë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 20.** *Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat konsideron si të padrejta dhe të pabazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit se: (i) nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të realizuar blerjen e automjetit tip “Ford Galaxy”, me targë {***}, me burim nga shitja e automjetit tjetër tip “Opel Corsa” në vitin 2009; dhe (ii) për pasaktësinë në deklarime lidhur me përdorimin e automjetit BMW nga vajza e tij, konstaton dhe analizon sa vijon.*

²⁹ Referuar *statement*-it të Raiffeisen Bank, të ardhurat nga paga për periudhën 01.01.2009 - 14.05.2009, rezultojnë në vlerën 529.185 lekë (Komisioni i ka përllogaritur ato në vlerën 622.851 lekë).

³⁰ Referuar *statement*-it të Bankës Tirana, të ardhurat nga paga për periudhën 01.01.2009 - 14.05.2009, rezultojnë në vlerën 231.432 lekë (Komisioni i ka përllogaritur ato në vlerën 310.558 lekë).

20.1. Në vendimin e Komisionit, për automjetin “Ford Galaxy” me targë {***}, është arsyetuar dhe konkluduar se:

Subjekti, në deklaratën “vetting”, ka deklaruar si burim për këtë automjet të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”, ndërkohë në DPV-2012, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e tij të vitit dhe në asnjë moment nuk ka deklaruar si burim kursimet cash.

Në përfundim, Komisioni çmon se gjendemi të paktën para plotësimit të deklaratës “vetting” jo në përputhje me kërkesat e ligjit, për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë; për pasojë, zbatimi i nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, që e konsideron deklaratën “vetting” të saktë, nuk gjen zbatim. Gjithashtu, subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të financuar blerjen e automjetit tip “Ford Galaxy”, në shumën 157.844,15 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Në të njëjtën mënyrë, si më lart, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme, Komisioni do e vlerësojë këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

20.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit janë tërësisht të papazuara duke u shprehur se në dhjetor të vitit 2011, ka pasur gjendje *cash* 600.000 lekë, në të cilën ka të përfshira edhe të ardhurat e automjetit të shitur. Duke pasur këtë gjendje *cash*, subjekti pretendon se e ka përdorur atë gjatë vitit dhe e ka zëvendësuar me të ardhurat vjetore të tij dhe të bashkëshortes, duke qëndruar ajo (gjendja *cash*) e pandryshuar në fund të vitit 2012. Subjekti në ankim shprehet se automjetin në janar të vitit 2012, e ka blerë me këtë gjendje *cash*, ndërsa me deklaramin në deklaratën *vetting*, se si burim financimi kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit “Opel Corsa”, ka pasur si qëllim të tregojë se me çfarë është furnizuar gjendja e *cash*-it në fund të vitit. Subjekti pretendon se nuk ka asnjë logjikë ekonomike që të disponosh gjendje *cash* në shtëpi me të ardhura të ligjshme dhe të arrihet në konkluzionin se nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, duke llogaritur vetëm të ardhurat e 14 ditëve të janarit 2012.

20.3. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues fillimisht mori në shqyrtim pretendimin e subjektit për përdorimin e kursimeve *cash* të disponuara në fund të vitit 2011, për blerjen e automjetit në janar të vitit 2012, për të cilin konstaton se:

Me anë të kontratës “Shitblerje automjeti” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin “Ford Galaxy”, me çmimin 200.000 lekë. Bazuar në deklaratën doganore import 4, vlera e detyrimeve tatimore ka qenë në shumën 62.755 lekë.

Në deklaratën *vetting*, si burim për blerjen e automjetit “Ford Galaxy”, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Opel Corsa”, me kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.12.2010. Ndërkohë, në DVP-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga shitja e autoveturës “Opel Corsa” me anë të kontratës {***}, datë 20.12.2010, në shumën 230.000 lekë, por ai nuk ka deklaruar shtim të kursimeve në *cash* për këtë vit.

20.4. Në këto kushte, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se jo vetëm që këto të ardhura nuk janë deklaruar si kursime në *cash* në këtë vit dhe as evidentuar në ndonjë mënyrë si një gjendje e tillë për vitin 2011, ato nuk janë deklaruar si burim krijimi për pasurinë automjet “Ford Galaxy” as në DPV-në e vitit 2012, kur ajo është krijuar. Në DPV-në e vitit 2012,

subjekti deklaron se automjeti është blerë duke pasur si burim krijimi të ardhurat e realizuara nga paga e të dy bashkëshortëve. Për pasojë, deklarimi i bërë në deklaratën *vetting* për përdorimin si burim të të ardhurave të krijuara nga shitja e automjetit “Opel Corsa”, nuk mbështetet, madje bie në kundërshtim me deklaratimet e bëra prej subjektit në deklaratat respektive. Në këto kushte, mbështetur në dy elemente, *së pari*, mosdeklarimi i gjendjes së *cash*-it të krijuar prej shitjes së automjetit “Opel Corsa” në vitin 2010, si edhe deklarimi si burim krijimi i të ardhurave nga paga në vitin 2012, kur është blerë pasuria objekt kontrolli, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit se ka përdorur të ardhurat nga shitja e automjetit “Opel Corsa” për të krijuar pasurinë automjet “Ford Galaxy”, mbetet i paprovuar dhe, për pasojë, analiza e Komisionit për kontrollin e burimeve të kësaj pasurie, është e mbështetur në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

20.5. Përveç sa më sipër, subjekti ka adresuar disa kundërshti për analizën financiare të kryer nga Komisioni deri në momentin e krijimit të pasurisë automjet “Ford Galaxy”, sipas të cilave pretendon se: **(i)** Komisioni në analizën financiare të kryer për automjetin “Opel Corsa”, ka përlllogaritur gabim të ardhurat nga paga të bashkëshortes së tij. Sipas subjektit, të ardhurat nga paga e bashkëshortes së tij, referuar nxjerrjes së llogarisë në Tirana Bank, për periudhën 01.01.2009 - 07.03.2009, janë në vlerën 182.842 lekë, ndërsa nëse i referohemi vërtetimit të lëshuar nga Dega e Arkivit Qendror me nr. {***} prot., datë 21.09.2021, të ardhurat neto të përfutuara nga shoqëria “{***}” rezultojnë në vlerën 189.120 lekë; **(ii)** subjekti pretendon se më 31 dhjetor të vitit 2011, ka pasur gjendje *cash* 600.000 lekë, në të cilat kanë qenë të përfshira edhe të ardhurat nga shitja e automjetit “Opel Corsa”, të cilën e ka përdorur përgjatë vitit dhe e ka zëvendësuar me të ardhurat vjetore, duke e lënë të pandryshuar deri në fund të vitit 2012, duke financuar në këtë mënyrë edhe për blerjen e automjetit në janar të vitit 2012; **(iv)** pas korrigjimit të të ardhurave nga paga e bashkëshortes, ku, sipas tij, referuar llogarisë bankare të saj në Tirana Bank, këto të ardhura janë në shumën 71.177 lekë, si dhe të gjendjes së likuiditeteve më datë 31.12.2011, e cila është e njëjtë me atë të datës 01.01.2012, në shumën 152.152 lekë (referuar tabelës së likuiditeteve të KPK-së), ai rezulton me mundësi financiare në vlerën 25.236 lekë.

20.6. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim këto pretendime nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, e cila pasi kontrolloi analizën e kryer prej Komisionit në funksion të këtyre shkaqeve të ankimit, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

(i) Qëndron pretendimi i subjektit se të ardhurat nga paga të bashkëshortes, referuar llogarisë bankare në Tirana Bank, janë në shumën 71.177 lekë. Komisioni i ka përlllogaritur ato në vlerën 35.589 lekë, referuar totalit të të ardhurave të vitit 2012, dhe jo referuar llogarisë së pagës së bashkëshortes së subjektit në Bankën Tirana. **(ii)** Nuk qëndron pretendimi i subjektit se gjendja e likuiditeteve bankare më datë 14.01.2012 është e njëjtë me gjendjen më datë 31.12.2011, pasi paga e muajit dhjetor ka kaluar në muajin janar 2012, fakt që tregon se gjendja e likuiditeteve bankare nga data 31.12.2011 në datën 14.01.2012, ka ndryshuar. Në këto kushte, duke vlerësuar pretendimet e subjektit sipas arsyetimit të mësipërm, në ndryshim nga vlera e përcaktuar në analizën financiare të Komisionit prej (-) 157.844 lekësh, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 122.256 lekë, për blerjen e automjetit “Ford Galaxy”.

20.7. Në përfundim, lidhur me pasurinë automjet “Ford Galaxy”, me targë {***}, të blerë në vitin 2012, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20.8. Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërlllogaritjen si shpenzim të tatimit për shitjen e automjetit “Opel Corsa” në vlerën 69.530 lekë, në analizën financiare të vitit 2010, trupi gjykues konstaton sa vijon.

20.9. Subjekti, së bashku me deklaratën “vetting”, ka bashkëlidhur kontratën e shitblerjes së automjetit tip “Opel Corsa”, si dhe një deklaratë me shkrim dore, datë 10.12.2010, të z. L. H., i cili deklaroi se ka marrë nga subjekti shumën 69.530 lekë, e cila përfaqëson tatimin për mjetin e shitur. I pyetur në lidhje me këtë deklaratë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se: *Me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 10.12.2010, kam shitur automjetin me blerës, z. L. H.. Nuk kam dijeni mbi faktin e pretenduar nga ju se: “Bashkëlidhur kontratës së bashku me deklaratën “vetting”, kam depozituar një kopje të një shkrese dore të blerësit L. H. që deklaroi se ka marrë shumën 69.530 lekë nga ana e tij, e cila përfaqëson tatimin për mjetin”, për këtë arsye nuk mund të shprehem mbi të. Gjithashtu, nga interesimi im pranë noterit, znj. M. P., nuk rezultoi që bashkëlidhur kësaj kontrate të jetë depozituar një deklaratë me shkrim dore nga z. L. H..*

Gjithashtu, vetë subjekti në dy analizat financiare të paraqitura prej tij në ankim, në vitin 2010 ka përlllogaritur vlerën 69.530 lekë, si tatim për shitjen e automjetit “Opel Corsa”.

20.10. Përveç sa më sipër, konstatohet se konsiderimi ose jo i vlerës prej 69.530 lekësh si shpenzim në ngarkim të subjektit për vitin 2012, nuk afekton analizën financiare të tij për këtë vit, duke qenë se ajo rezultoi me balancë pozitive në secilin version. Për pasojë, trupi gjykues e vlerësoi pa peshë analizimin më tej të këtij pretendimi të subjektit.

21. Lidhur me pretendimet e subjektit të cilat kundërshtojnë si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për përdorimin e automjetit BMW nga vajza e tij, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

21.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e të drejtave të përdorimit/pronësisë së personit të lidhur, vajzës së subjektit M. L., pasi janë renditur faktet që kanë rezultuar nga hetimi dhe analizuar posaçërisht përmbajtja e një prokure të posaçme nga pronari i mjetit, z. G. P., që autorizonte vajzën e subjektit në përdorimin e automjetit si të ishte i saj, është konkluduar se:

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim se pse ende deri aktualisht nuk është revokuar prokura e lëshuar nga z. P., sipas së cilës vajza e subjektit ka pasur të gjithë tagrat e përfaqësimit për automjetin më lart. Subjekti nuk dha asnjë shpjegim se cilat kanë qenë arsyet që nuk ka deklaruar në pyetësorin standard përdorimin e këtij automjeti. Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se (i) pjesë përbërëse e prokurës së nënshkruar nga z. P., është dhe karta e identitetit e znj. M. L.; (ii) në prokurë deklarohet qartë se prokura është pa afat dhe nuk mund të revokohet nga ana e z. P. pa pëlqimin e vajzës së subjektit; (iii) subjekti nuk depozitoi asnjë dokument për të provuar që kjo prokurë është revokuar; vlerëson se jemi para një prokure fiktive, e cila

duket sikur është kontratë dhurimi dhe se subjekti duhej të ishte transparent me Komisionin, duke deklaruar përdorimin e saj në pyetësonin standard. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me këtë automjet, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

21.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, ka pretenduar se:

Komisioni pa të drejtë interpreton një akt të njëanshëm, të lëshuar nga ana e pronarit të automjetit, siç është prokura e përfaqësimit, duke e cilësuar atë si “Kontratë dhurimi”.

Pikësëpari, ky fakt është tërësisht i pavërtetë, pasi vajza ime thjesht e ka përdorur automjetin, për shkak të marrëdhënieve miqësore të ruajtura prej vitesh, por në asnjë rast nuk është menduar si i dhuruar apo i tjetërsuar me të drejta të plota reale tek ajo.

Kjo prokure jo vetëm që nuk është fiktive, pasi nuk përmbush elementet e trajtuara më lart, por është krejtësisht e njëanshme, sikurse e kërkon vetë ligji, e hartuar vetëm për qëllime të lëvizjes së vajzës me këtë automjet, të autorizuar nga vetë pronari i automjetit, shtetasi G. P., i cili edhe në deklaratën e tij noteriale, deklaroi se për shkak të gjendjes së amortizuar të tij dhe modelit tepër të vjetër, ky automjet nuk përdorej nga ana e tij... këtë automjet ia ka lënë në përdorim nga viti 2011 e në vazhdim shtetases M. Artan Lulaj për ta përdorur për nevojat e saj personale, për shkak të marrëdhënieve të miqësisë!

Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit, sqaroj se nuk kam vlerësuar ta deklaroj përdorimin e automjetit të vajzës sime, për sa kohë, përveç faktit se nuk ka qenë detyrim ligjor deklarimi i tij, sipas ligjit të posaçëm, gjithashtu nuk ndodhemi as përpara fitimit të të drejtave pasurore të një pasurie, shitjes, dhurimit apo marrëdhënies së huasë, veprime juridike të cilat detyrojnë subjektet që të deklarojnë në Deklaratën e Interesave Privatë Periodikë Vjetorë. Për më tepër që ky pretendim i ngritur nga Komisioni, tejkalon edhe vetë qëllimin e procesit të rivlerësimit, në kuptim të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

21.3. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në analizë aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, nga të cilat rezultoi se personi i lidhur nuk ka bërë deklarime lidhur me përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *vetting*. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard, nuk ka deklaruar përdorimin e automjetit BMW prej saj. Me anë të pyetësorit vijues, nr. 1, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë arsyet përse vajza e tij, M. L., rezultoi të ketë prerë policia sigurimi për automjetin BMW (me targë {***}). Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se vajza është përdoruese e këtij automjeti, për të cilin pronari i tij, z. P., për shkak të miqësisë, i ka lënë të drejtën e përdorimit. Në mbështetje të këtij shpjegimi, subjekti ka paraqitur si provë aktet: (i) “Prokurë e posaçme” nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 13.11.2008, me anë të së cilit blerësi i automjetit, z. G. P., i jep të gjithë tagrat ligjorë vajzës së subjektit M. L., që automjetin BMW ta përdorë, ta shesë, ta dhurojë, t’ua japë në përdorim të tretëve, po ashtu në këtë deklaratë, në pjesën e fundit të saj, shprehet se: *Nga ky moment, përfaqësuesja ka të drejtën e përfitimit të të gjithë të ardhurave financiare në shitje, duke deklaruar unë likuidimin nga ana e këtij të fundit. Prokura është pa afat dhe nuk mund të revokohet nga ana ime pa pëlqimin e përfaqësueses;* (ii) “Deklaratë noteriale” nr. {***}, datë 16.09.2021, të lëshuar nga z. G. P. në të cilën ai deklaroi se: *për shkak të gjendjes së amortizuar, ky automjet nuk përdorej nga unë. Meqenëse nga mospërdorimi ky automjet mund të amortizohej në gjendje të pariparueshme, këtë automjet ia kam lënë në përdorim që nga viti 2011 e në vazhdim shtetases M. L., për ta përdorur për nevojat e saj personale për të praktikuar*

drejtimitin e mjetit, për shkak të transmisionit manual të automjetit. Me shtetasen M. L., kemi marrëdhënie miqësie.

21.4. Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues konstaton se përmbajtja e aktit “Prokurë e posaçme”, nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 13.11.2008, evidenton se pronari i automjetit BMW, z. P. i kalon të gjithë tagrat ligjorë mbi automjetin vajzës së subjektit, duke e autorizuar atë jo vetëm ta përdorë automjetin BMW, por edhe ta shesë atë, duke shtuar se ai nuk mund ta revokojë këtë prokurë pa pëlqimin e përfaqësueses. Në këto kushte, konstatohet se marrëdhënia e vajzës së subjektit me automjetin BMW, me targë {***}, ka qenë e pandërprerë, duke zotëruar të drejta jo vetëm përdorimi³¹, por edhe ato që zakonisht janë tagra që i takojnë pronarit, siç është dhënia në përdorim të tretëve, e drejta e shitjes së tij dhe përfitimit të të ardhurave prej tij. Të dhënat që janë përfutur prej hetimit, të pohuara edhe prej vetë subjektit, provojnë se vajza e tij e ka përdorur automjetin pa ndërprerje deri në amortizimin e tij dhe daljen jashtë përdorimit. Fakti që në prokurën e posaçme autorizohen të drejta të lidhura me këtë pasuri sikur ato që përmban titulli i pronësisë, pavarësisht se nuk ka pasur një pohim të shprehur të vajzës së subjektit për t’i pranuar ato, karakteristikë e kontratave të dhurimit, ajo ka pranuar pasojat ligjore të këtij akti me veprime konkludente, duke qenë se e ka përdorur atë deri në daljen jashtë përdorimit. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur/subjekti kishin detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratat periodike të pasurisë, duke qenë se në thelb ajo përfaqëson tagra pronësie mbi automjetin objekt kontrolli, të cilat ishin fituar prej vajzës së subjektit dhe ishin humbur prej pronarit formal të tij, për sa kohë që ai vetë deklaroi se ajo, personi i lidhur, është i likuiduar me të edhe në rastin se vendos ta shesë automjetin. Pavarësisht këtij arsytimi, i cili në thelb mbështet qëndrimin e Komisionit, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje në deklaratën *vetting*, sa kohë që nuk ka të dhëna që ky automjet të ketë qenë në përdorim të personit të lidhur në kohën e përpilimit të saj, rrethanë që e bën të besueshëm argumentin se ai ka qenë jashtë përdorimit për shkak amortizimi, konsideruar edhe vitin e prodhimit të tij, në vitin 1989, konsideron të pasaktë konkluzionin se subjekti duhet të përgjigjet në këtë rast për deklaram të pamjaftueshëm sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, por meriton të vlerësohet në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të tri kriterëve, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

- 22.** *Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si të gabuar dhe të pabazuar në akte analizën financiare të Komisionit për vitin 2014, lidhur me (i) përllogaritjen e saktë të të ardhurave nga punësimi i tij dhe i vajzës D. L.; (ii) përfshirjen në analizë të shpenzimeve për ceremoni familjare në shumën 1.000.000 lekë; (iii) kursime cash deri më 31.12.2014 në shumën 1.300.000 lekë; për të cilat konstaton dhe analizon sa vijon.*

22.1. Lidhur me kursimet në *cash* në shumën 1.300.000 lekë, si dhe shpenzimet për ceremoni familjare në vitin 2014, Komisioni ka marrë në analizë deklaramet e subjektit në deklaratat periodike, ato të bëra në ILDKPKI dhe ato të bëra gjatë hetimit administrativ. Sipas tyre, Komisioni ka konstatuar se subjekti në procesverbalin e datës 03.03.2016³², ka deklaruar se gjendja *cash* më datë 31.12.2014 ka qenë 1.300.000 lekë, të cilën nuk e ka deklaruar si gjendje *cash*, por ka deklaruar vetëm të ardhurat e përfutuara nga ekzekutimi i vendimit në shumën

³¹ E provuar nga policat e sigurimit të mjetit, të lëshuara në emër të M. L., për periudhën 2011-2014.

³² Kthim përgjigje ILDKPI nr. {***} prot., datë 28.06.2021.

3.500.000 lekë, nga të cilat 1.500.000 lekë janë shpenzuar për mobilimin e shtëpisë dhe pjesa tjetër janë kursime.

Komisioni, referuar këtyre deklarimeve, por edhe deklarimit të subjektit në deklaratën “vetting”: “Shpenzime për rimobilim të po këtij apartamenti të kryera gjatë vitit 2014 në shumën 1.500.000 lekë. dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë”, ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare të vitit 2014 edhe shumën 1.000.000 lekë, të shpenzuar për ceremoni familjare. Mbi këto lexime, Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e subjektit për të krijuar kursime *cash* në shumën 1.300.000 lekë në vitin 2014, shumë e cila rezulton e mbartur në deklaratën “vetting”, si dhe për të përballuar shpenzimet për kryerjen e një ceremonie familjare në këtë vit, në vlerën prej 1.000.000 lekësh, nga e cila ka rezultuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 1.098.938 lekë për krijimin e kursimeve në *cash*.

22.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni pa të drejtë ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2014 shumën 1.000.000 lekë. Subjekti sqaron se ka vendosur pikë në fund të fjalisë së parë se ka shpenzuar 1.500.000 lekë për rimobilimin e apartamentit gjatë vitit 2014, ndërkohë që nuk ka filluar me shkronjë të madhe fjalinë e dytë, e ndoshta kjo ka krijuar konfuzion. Subjekti pretendon se shpenzimet për ceremoni familjare janë kryer në vitin 2015, për fillimin e bashkëjetesës së vajzës së tij, dhe për këtë shpenzim ka marrë një kredi në shumën 700.000 lekë, pranë Tirana Bank, si dhe 300.000 lekë nga kursimet familjare.

Po ashtu, në ankim, për analizën financiare të kryer për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit pretendon se: **(i)** paga e tij është përlllogaritur gabim, ku sipas llogarisë së tij bankare në Credins Bank, totali i pagave për vitin 2014 është në vlerën 1.478.575 lekë dhe jo në vlerën 1.409.232 lekë, të përlllogaritur nga Komisioni; **(ii)** Komisioni nuk duhet të përlllogariste shpenzimet e kryera me kartë, në vlerën 360.994 lekë, pasi ato janë blerje të kryera me kartë debiti dhe jo krediti. Subjekti pretendon se nëse reflektohen këto elemente në analizën financiare për vitin 2014, ai rezulton me situatë financiare pozitive në vlerën (+) 35.138 lekë.

22.3. Trupi gjykues, pasi mori në analizë pretendimet e mësipërme të subjektit për krijimin e kursimeve në *cash* në vitin 2014, konstatoi se: **(i)** në deklaratën “vetting”, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime për rimobilim të po këtij apartamenti, të kryera gjatë vitit 2014, në shumën 1.500.000 lekë. dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë”. Po ashtu, në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar: “Gjendje lekë *cash* 1.300.000 lekë”; **(ii)** subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2014, ka deklaruar shpenzim për arredim banese në shumën 1.500.000 lekë, dhe në DPV-në e vitit 2015, bashkëshortja e tij ka deklaruar se ka kryer shpenzime për ceremoni familjare (fejesë) dhe blerje artikujsh të ndryshëm, me kredi konsumatore të marrë nga Tirana Bank, në shumën 700.000 lekë; **(iii)** në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i ka sqaruar Komisionit se: *në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë vetting, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, kam deklaruar shprehimisht se: “shpenzime për rimobilim të po këtij apartamenti të kryera gjatë vitit 2014 në shumën 1.500.000 lekë. dhe shpenzime për ceremoni familjare 1.000.000 lekë”. [...] Për informimin tuaj, sqaroj se shpenzimet objekt analize janë kryer në vitin 2015 për fillimin e bashkëjetesës së vajzës time D. L. (H.), në muajin tetor 2015, për shkak të një shtate të paparashikuar [...];*

(iv) më datë 29.09.2015³³, subjekti së bashku me bashkëshorten e tij kanë lidhur kontratë kredie bankare konsumatore nr. 0461/25.09.2015, për marrjen e një kredie në shumën 700.000 lekë, nga Tirana Bank, me afat 5-vjeçar. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit, rezulton se kredia është disbursuar më datë 30.09.2015, në shumën 700.000 lekë dhe është tërhequr më datë 02.10.2015, në shumën 691.000 lekë.

22.4. Në referim të deklarimeve të mësipërme, por edhe të rrethanës faktike se fejesa e vajzës së subjektit ka ndodhur në vitin 2015, duke u bazuar kryesisht në informacionin që japin lëvizjet bankare dhe deklarimi i bashkëshortes së subjektit në DPV-në e vitit 2015, i cili në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë, trupi gjykues vlerësoi si të besueshëm deklarinin se shpenzimi për ceremoninë familjare në shumën 1.000.000 lekë është kryer nga subjekti në vitin 2015. Për këtë arsye, ky shpenzim u konsiderua në analizën financiare të kryer në Kolegj në vitin 2015. Po ashtu, në analizën financiare të kryer në Kolegj, janë përfshirë: (i) të ardhurat nga puna e subjektit në vlerën 1.478.575 lekë, pasi trupi gjykues konstatoi se qëndron pretendimi i subjektit se sipas të dhënave të evidentuara nga Banka Credins për kreditimet në llogarinë e tij, pagat e përfituara përgjatë vitit 2014 janë në vlerën 1.478.575 lekë dhe jo në vlerën 1.409.232 lekë të përlllogaritur nga Komisioni; (ii) të ardhurat e vajzës D. L. sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit dhe të evidentuara në vërtetimin nr. {***} prot., datë 26.01.2017, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë. Sipas këtij akti, rezulton se vajza e subjektit, për periudhën korrik - dhjetor, ka përfituar të ardhura bruto në vlerën 118.000 lekë dhe neto në vlerën 104.784 lekë. Totali i pagave të përfituara për vitin 2014 është në vlerën 85.248 lekë dhe jo në vlerën 31.724 lekë, të përlllogaritur nga Komisioni.

22.5. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk duhet të përlllogariste shpenzimet e kryera me kartë debiti në vlerën 360.994 lekë, trupi gjykues konstaton se ky pretendim i subjektit është pranuar³⁴ nga Komisioni, për aq kohë sa ky organ në analizën financiare përfundimtare nuk e ka përfshirë këtë vlerë si shpenzim.

22.6. Në përfundim, nga kontrolli që Njësia e Shërbimit Ligjor i bëri analizës financiare të kryer nga Komisioni, në konsideratë të konkluzioneve të mësipërme, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2014, kishte burime të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruar, në shumën 1.300.000 lekë, dhe analiza financiare për gjithë këtë vit rezultoi me balancë pozitive.

23. *Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues u ndal në analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton si të padrejtë dhe jo të saktë analizën e kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2016, për të cilat konstaton sa vijon.*

23.1. Komisionit, nga analiza financiare e kryer fillimisht për subjektin e rivlerësimit nga fillimi i detyrës deri në deklaratën “vetting”, vlera e pamundësisë kumulative financiare e subjektit i rezultoi 5.186.591 lekë³⁵.

³³ Informacion i marrë nga shkresa nr. {***} prot., datë 20.01.2020, e Bankës Tirana.

³⁴ Shprehur në faqen nr. 40 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi.

³⁵ Kjo vlerë i përket periudhës 1994-2016. Vendimi i Komisionit mban qëndrim për periudhën nga fillimi i detyrës deri në plotësimin e deklaratës “vetting”.

Komisioni, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, pas kalimit të barrës së provës, vlerësoi:

- i.** Të pranojë pretendimin e subjektit në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i noterisë vetëm për vitin 1996, duke i përlllogaritur të ardhurat totale nga aktiviteti i noterisë (për vitet 1994-2000) në vlerën 4.947.825 lekë.
- ii.** Të pranojë pretendimin e subjektit në lidhje me pagat e përfituara nga bashkëshortja e tij pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën qershor 2012 - gusht 2013, duke i përfshirë ato në analizën financiare, për sa kohë rezultuan se janë paguar detyrimet tatimore. Totali i të ardhurave nga pagat e bashkëshortes pranë shoqërisë “{***}” ShPK, është përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 6.309.596 lekë, vlerë kjo e pretenduar nga subjekti, referuar vërtetimeve të organeve tatimore.
- iii.** Komisioni ka vlerësuar të mos konsiderojë të ardhurat nga shpërblimet, për aq kohë sa nuk u provua me dokumentacion provues pagimi i detyrimeve tatimore për shumën 13.640.000 lekë.
- iv.** Të pranojë pretendimin e subjektit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në vitin 2010 dhe vitin 2016. Totali i shpenzimeve të udhëtimit në vitin 2010 është përlllogaritur në vlerën 529.005 lekë dhe për vitin 2016 në vlerën 256.742 lekë, vlera këto të njëjta me ato të pretenduara nga subjekti.
- v.** Të pranojë pretendimin e subjektit për të ardhurat nga paga të tij, për vitin 2010, duke i përlllogaritur ato në vlerën 1.536.064 lekë, në analizën financiare të vitit.
- vi.** Të pranojë pretendimin e subjektit për mospërlllogaritje në analizë financiare të shpenzimeve të kryera me kartë debiti.

Në përfundim, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 4.414.333 lekë, për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, nga fillimi i detyrës në vitin 2000 deri në dorëzimin e deklaratës *vetting*.

23.2. *Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pasaktë dhe të bazuar në prova analizën financiare të Komisionit, në drejtim të elementeve si më poshtë.*

- i.** Të ardhurat totale të përfituara nga aktiviteti noterisë, për vitet 1994-2000, janë në vlerën 6.130.275 lekë, dhe jo në vlerën 4.947.825 lekë, të përlllogaritur nga Komisioni.
- ii.** Të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortes në shoqërinë “{***}” ShPK, për periudhën 2008-2015, janë në shumën 13.640.000 lekë, ku 6.309.596 lekë janë totali i pagave mujore të deklaruara në sistemin tatimor dhe diferenca është përfituar nga shpërblime gjatë vitit, të paguara nga arka e punëdhënësit, mbi të cilat shoqëria ka paguar tatimin në burim.
- iii.** Të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit me vlerë 1.500.000 lekë, në vitin 2001, duhet të përfshihen në analizën financiare.
- iv.** Trualli me sip. 314 m², blerë në vitin 2001 nga Bashkia Sarandë, duhet të përlllogaritet në vlerën 150.720 lekë, dhe jo në vlerën 161.932 lekë të përlllogaritur nga Komisioni.
- v.** Trualli me sip. 662 m², blerë nga Bashkia Sarandë, duhet të përlllogaritet në vlerën 397.200 lekë, dhe jo në vlerën 503.000 lekë të përlllogaritur nga Komisioni.
- vi.** Nuk duhet të përlllogaritet vlera 2.544.410 lekë për ndërtimin e banesës, pasi ky truall është shitur pa ndërtesë.
- vii.** Detyrimi ndaj shoqërisë “{***}” ShPK për vlerën 5.368 euro është shlyer në vitin 2010 për vlerën 2.500 euro dhe në vitin 2011 për vlerën 2.868 euro, dhe jo në vitin 2009 të konsideruar nga Komisioni.

- viii.** Pagat e përfituara prej tij në vitin 2010, referuar llogarisë bankare, janë në vlerën 1.533.965 lekë, dhe jo në vlerën 1.228.064 lekë të përlllogaritur nga Komisioni.
- ix.** Nuk duhet të përlllogariten shpenzime për detyrim tatimor në vlerën 69.530 lekë, për shitjen e automjetit “Opel Corsa”, pasi vlera e shitjes është më e vogël se vlera e blerjes së këtij automjeti.
- x.** Llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2010 dhe vitin 2016 e kryer nga Komisioni, është e pasaktë. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2010 janë në vlerën 529.005 lekë, dhe për vitin 2016 janë në vlerën 256.742 lekë.
- xi.** Llogaritja e shpenzimeve për ceremoni familjare në vlerën 1.000.000 lekë, të kryera në vitin 2015 dhe jo në vitin 2014, të konsideruar nga Komisioni.
- xii.** Në përfundim, subjekti pretendon se për çdo vit, për periudhën 2003-2016, duke marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e tij³⁶, ai ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe për kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me bilanc pozitiv, në vlerën 11.744.811 lekë.

23.3. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016, konstatoi se:

Së pari, subjekti në ankimin e tij ka paraqitur pretendime të cilat Komisioni i ka pranuar si të vërteta në vendimin përfundimtar, pas shpjegimeve që subjekti ka dhënë në përgjigje të barrës së provës, të cilat kanë të bëjnë me: **(i)** shpenzimet e udhëtimit në vitin 2010 dhe vitin 2016. Totali i shpenzimeve të udhëtimit është ripërlllogaritur nga Komisioni, për vitin 2010 në vlerën 529.005 lekë, dhe për vitin 2016 në vlerën 256.742 lekë, vlera këto të njëjta me ato të pretenduara nga subjekti në analizën e tij financiare; **(ii)** të ardhurat e tij nga paga, duke i ripërlllogaritur ato në vlerën 1.536.064 lekë, në analizën financiare të vitit 2010; **(iii)** mospërlllogaritje në analizë financiare të vlerës së shpenzimeve të kryera me kartë debiti, të cilat, siç është evidentuar më lart, nuk janë përfshirë si shpenzime.

23.4. Gjithashtu, trupi gjykues, siç është arsyetuar në paragrafët më lart në këtë vendim, në analizën e kryer prej tij, në ndryshim nga Komisioni, ka vlerësuar si të drejta pretendimet e subjektit se: **(i)** të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit me vlerë 1.500.000 lekë, në vitin 2001, duhet të përlllogariten në analizën financiare të vitit 2001. Meqenëse rezultati financiar i këtij viti është përpara periudhës së deklaramit, ai mbetet pa ndikim në rezultatin tërësor të periudhës së analizuar 2003-2016; **(ii)** të ardhurat nga puna e subjektit për vitin 2014 janë në vlerën 1.478.575 lekë, dhe jo në vlerën 1.409.232 lekë të përlllogaritur nga Komisioni; **(iii)** shpenzimet për ceremoni familjare në vlerën 1.000.000 lekë nuk duhen përlllogaritur si një shpenzim i kryer në vitin 2014, siç është konsideruar nga Komisioni, por konsideron të drejtë qëndrimin e subjektit se ato janë një shpenzim i kryer në vitin 2015.

23.5. Trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përlllogaritjen e vlerës së truallit me sipërfaqe 314 m² dhe atij me sipërfaqe 662 m², blerë nga Bashkia Sarandë. Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatohet se Komisioni, në analizën financiare, ka përlllogaritur vlerën totale të truallit me

³⁶ Subjekti pretendon se edhe në rast se të ardhurat e bashkëshortes nga puna në shoqërinë “{***}” përlllogariten në vlerën 6.309.596 lekë, duke mos konsideruar të ardhurat nga shpërblimet, analiza financiare sërish rezulton me bilancë pozitive.

sipërfaqe 314 m² në vlerën 161.932 lekë, vlerë në të cilën përfshihet vlera 150.720 lekë për blerjen e truallit, si dhe pagesa e kryer për leje ndërtimi³⁷ në vlerën 56.212 lekë. Gjithashtu, edhe për përllogaritjen e vlerës totale të truallit me sipërfaqe 662 m², Komisioni në analizën financiare ka përllogaritur vlerën 503.000 lekë, vlerë në të cilën përfshihet vlera 397.200 lekë për blerjen e truallit, si dhe pagesa e kryer për leje ndërtimi në vlerën 105.800 lekë³⁸. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson të padrejtë pretendimin e subjektit për përllogaritje jo të saktë nga ana e Komisionit të vlerës së dy trojeve të blera në qytetin e Sarandës dhe, bazuar në informacionin që ofrojnë aktet e siguruara nga hetimi administrativ, përllogaritja e analizës së Komisionit për blerjen dhe shpenzimet për pajisje me leje ndërtimi, konstatohet e saktë.

23.6. Trupi gjykues, në kuadër të këtij shkakut ankimi, mori në analizë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij pranë shoqërisë “{***}” ShPK. Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatohet se: **(i)** subjekti në deklaratën *vetting*, ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar të ardhura nga paga në shoqërinë “{***}” ShPK, në shumën 13.640.000 lekë, për periudhën qershor 2008 deri në shtator 2015; **(ii)** në DPV-të e viteve 2008-2015, ka deklaruar në total si të ardhura vlerën 12.276.000 lekë; **(iii)** referuar vërtetimit të datës 28.10.2016, të shoqërisë “{***}” ShPK, deklarohet se znj. F. L. ka realizuar të ardhura nga paga dhe bonuse për periudhën qershor 2008 - shtator 2015 në vlerën 13.640.000 lekë; **(iv)** nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Tirana Bank, rezulton se ajo ka përfituar në total shumën 5.125.057 lekë për periudhën dhjetor 2008 - janar 2016; **(v)** referuar vërtetimit nr. {***} prot., datë 21.09.2021, të Drejtorisë së Arkivit Qendror të Rajonit Tiranë, për periudhën tetor 2008 - dhjetor 2011, rezulton që znj. F. L. të ketë përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën 2.647.776 lekë dhe, referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar të datës 16.09.2021, lëshuar nga ISSH-ja, rezulton se znj. F. L., për periudhën janar 2012 - janar 2016, ka përfituar të ardhura nga paga neto në vlerën 3.661.820 lekë; **(vi)** bazuar në dy vërtetimet e depozituara nga subjekti në Komision me përgjigjet për pyetëtorin nr. 2³⁹, rezulton se në total

³⁷ Në dokumentacionin e ZVRPP Sarandë, gjendet mandat arkëtimi i datës 18.12.2001, paguar nga subjekti në favor të Bashkisë Sarandë.

³⁸ Paguar më datë 03.11.2003, për blerje trualli/leje ndërtimi, gjendur në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja, depozituar nga ZVRPP Sarandë.

³⁹ Subjekti, në përgjigje të pyetëtorit nr. 1 dhe pyetëtorit nr. 2, ka sqaruar se: “Bashkëshortja ka punuar pranë shoqërisë “{***}” ShA, përgjatë periudhës qershor 2008 - shtator 2015. Gjatë kësaj kohe, krahas pagës mujore për të cilën rezulton e pasqyruar edhe në sigurimet shoqërore, e siguruar me pagë maksimale, ka marrë rregullisht shpërblime nga arka e shoqërisë. Për këto shpërblime, është paguar tatimi në burim nga shoqëria dhe njëkohësisht është reflektuar në bilancin e kësaj shoqërie [...] Shuma prej 6.309.596 (gjashtë milionë e treqind e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh konsiston në pagat mujore të deklaruara në Sistemin Tatimor dhe pranë Sigurimeve Shoqërore, mbi të cilat janë paguar kontribute dhe tatimi mbi pagat. Periudhat: tetor – nëntor 2008, qershor – dhjetor 2012 dhe janar – gusht 2013 janë deklaruar në listëpagesat mujore të depozituara pranë Sigurimeve Shoqërore dhe organeve tatimore, por janë tërhequr CASH nga arka e shoqërisë për shkaqe subjektive të shoqërisë. Diferenca midis shumës së deklaruar, 13.640.000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë, në deklaratën “vetting” dhe pagave mujore, në vlerën 6.309.596 (gjashtë milionë e treqind e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë është përfituar nga shpërblime gjatë vitit, të paguara nga arka e punëdhënësit, mbi të cilat shoqëria ka paguar tatimin në burim. Gjatë kohës që ka punuar në këtë shoqëri, është paguar me pagën maksimale mbi të cilën derdhen kontributet ose më të madhe se ajo. Gjithashtu, shuma vjetore,

bashkëshortja e subjektit, për periudhën tetor 2008 - janar 2016, ka përfituar të ardhura nga paga në vlerën 6.309.596 lekë.

23.7. Trupi gjykues, në drejtim të identifikimit të vlerës që duhej përfshirë në analizën financiare si e ardhur nga paga e bashkëshortes së subjektit nga punësimi i saj pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën tetor 2008 - janar 2016, pranoi si të bazuar përlllogaritjen e kësaj vlere nga Komisioni në shumën 6.309.596 lekë, e cila korrespondon edhe me shumën mbi të cilën janë paguar detyrimet tatimore. Ashtu si dhe Komisioni, trupi gjykues në Kolegj, ka vlerësuar të mos përfshijë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti se janë përfituar nga bashkëshortja e tij në formën e shpërblimit, për aq kohë sa nuk u provua me dokumentacion provues përftimi i tyre dhe as pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura, në vlerën prej 7.330.404 lekësh. Dokumenti i vetëm i cili mbështet këtë pretendim të subjektit, është vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në datën 28.10.2016, i cili përkon me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 e që sugjeron lëshimin e tij për efekt të këtij procesi. Përftimi i këtyre të ardhurave, përveç deklarimit të subjektit në deklaratat periodike, nuk mbështetet në asnjë dokument ligjor të kohës së përftimit të tyre apo në ndonjë akt shkresor i cili do të sillte qoftë edhe indicie, kryesisht për përftimin e tyre. Përveç kësaj, nga të dhënat e përfituara prej organeve tatimore e ISSH-së, nuk rezulton asnjë e dhënë që bashkëshortja e subjektit të ketë përfituar ndonjë vlerë më të madhe se paga e saj, e cila është konsideruar e gjitha si e ardhur e ligjshme prej Komisionit. Pavarësisht këtij arsytimi rreth mungesës së provueshmërisë së të ardhurave të pretenduara, trupi gjykues sjell në vëmendje se kjo vlerë e pretenduar si e përfituar nga shpërblime e bonuse, edhe nëse do të provohej se ishte përfituar realisht, nuk provohet t’i jetë nënshtruar regjimit tatimor të së ardhurës së ligjshme sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë me të drejtë ajo nuk është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare si e tillë.

23.8. Në referim të konkluzioneve të mësipërme, edhe për blerjen e apartamentit në Plazh, Durrës, trupi gjykues, edhe pse nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni për këtë pasuri, evidentoi se balanca negative e subjektit ishte më e lartë se ajo e konkluduar prej Komisionit, në aplikim të parimit *no reformatio in peius*, për efekt të analizës financiare, konsideroi konkluzionin e vendimit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme në masën në masën (-) 501.987 lekë për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe për të realizuar pagesën e këstit të fundit të këtij apartamenti, në vitin 2009.

Në reflektim të konkluzioneve për shkaqet e analizuara më sipër, trupi gjykues konkludon se nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 2003- 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton në total me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 1.848.862 lekë për realizimin e investimeve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

23.9. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën e kryer nga Komisioni, konkludoi se për të gjithë periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në vlerën (-) 1.848.862 lekë për krijimin e pasurive dhe përbalimin e

pagë + shpërblime, marrë në arkë dhe bankë, nuk e ka kaluar asnjëherë shumën prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh, çka do ta detyronte atë të deklaronte në DIVA”.

shpenzimeve, e cila krijohet nga balanca negative në vitin 2003 në vlerën (-) 1.414.839 lekë⁴⁰ dhe në vitin 2009 në vlerën (-) 434.023 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

24. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat ai konsideron si të gabuara dhe jo të bazuara ligjërisht qëndrimet e Komisionit në drejtim të kontrollit të ushtuar për pasurinë e vajzës së tij D. H. (L.) dhe bashkëshortit të saj, të krijuara pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, analizon sa vijon.

24.1. Në vendimin e Komisionit, për pasurisë e vajzës së subjektit D. H. (L.), si person i lidhur me të, është analizuar se:

*Në datën 8.3.2021, vajza e subjektit, D. H. (L.), së bashku me bashkëshortin e saj, R. H., kanë lidhur kontratë shitjeje pronësie me rezervë nr. {***}, duke blerë nga shitësit L., M. dhe I. Th. (përfaqësuar nga av. A. K.) dhe F. K., apartament me sipërfaqe 59,5 m², me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, në rrugën “{***}” dhe apartament me sipërfaqe 93 m², me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, në rrugën “{***}”. [...]*

Subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vajzës së tij dhe bashkëshortit të saj për blerjen e këtij apartamenti dhe rikonstruksionin e tij. Subjekti ka refuzuar të deklarojë shpenzimet e kryera për rikonstruksionin e apartamentit, si dhe burimin e tyre. Për sa më sipër, Komisioni e ka të pamundur për të dhënë një vlerësim të plotë për këtë pasuri, ku në pamje të parë, bazuar në çmimin e ulët të blerjes së apartamenteve, të deklarimeve kontradiktore të subjektit në lidhje me statusin e kësaj pasurie dhe të mungesës së bashkëpunimit të tij, ngrihen dyshime për mungesë burimesh të ligjshme për blerjen dhe rikonstruksionin saj, si dhe të fshehjes së mundshme të të ardhurave. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka tentuar të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të po këtij ligji.

24.2. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit pretendon se mbetet i pakuptimtë konkluzioni i Komisionit “për pasuri të fshehur”, kur pasuritë nga vajza e tij janë përfituar në vitin 2021, dhe se në pyetësorin e datës 07.09.2021 është përgjigjur se burimi i financimit të tyre është me kredi, pjesërisht me të ardhura nga biznesi, pjesërisht nga kursime familjare, pagat e vajzës dhe të bashkëshortit. Në ankim, ashtu si edhe në Komision, subjekti pretendon se përfshirja e vajzës së tij dhe e bashkëshortit në rrethin e personave të lidhur është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, neni 32, pika 4 e këtij ligji, si edhe me jurisprudencën e Kolegjit të mbajtur në vendimin (JR) 15/2019, duke cituar arsyetimin e Kolegjit për rrethin e personave të tjerë të lidhur. Ai pretendon se pasuritë e vajzës së tij që nuk janë bërë ende objekt

⁴⁰ Kjo balancë negative vjen si rezultat i përlogaritjes në analizën financiare të kostos së ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m², në qytetin e Sarandës.

kontrolli nga ILDKPKI-ja, nuk mund të bëhen objekt verifikimi në procesin e rivlerësimit kalimtar.

25. Trupi gjykues i konsideroi si të drejta dhe të bazuara ligjërisht pretendimet e subjektit me të cilat kundërshton qëndrimin e Komisionit se ka tentuar të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë e personit të lidhur (në këtë rast, të vajzës së tij), pasi, nga të dhënat që ofrojnë aktet e fashikullit të Komisionit, rezultojnë se vajza e subjektit të rivlerësimit⁴¹, në momentin e plotësimit në cilësinë e personit të lidhur, të shtojcës së deklaratës *vetting*, nuk kishte në pronësi 2 (dy) apartamentet në Tiranë, blerja e të cilave është realizuar më datë 08.03.2021⁴² dhe përbën në këtë rast, një pasuri të krijuar përtej periudhës së rivlerësimit. Në këto kushte, ndonëse ajo e gëzon statusin e personit të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë pasuritë objekt kontrolli janë fituar pas deklaratës *vetting* dhe nuk rezultojnë ndonjë e dhënë që ato të kenë burimin nga pasuritë e deklaruara apo të gjeneruara gjatë periudhës së rivlerësimit, trupi gjykues, ashtu si edhe në qëndrimet e mëparshme në jurisprudencën e tij, në zbatim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se ato nuk mund të jenë objekt kontrolli nga organet e rivlerësimit.
26. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në këndvështrim të të gjitha konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të ketë një nivel të besueshëm për këtë kriter, por se ai gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm lidhur me të sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

D. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

27. Trupi gjykues mori në analizë shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në të cilin Komisioni ka konstatuar problematika për dy procedime penale të ndjekura prej subjektit, duke pretenduar respektivisht se: *Vlerësimi dhe konkluzioni i vendimit të Komisionit për procedimin penal nr. {***}, të regjistruar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, ka të bëjë me themelin e çështjes dhe, si i tillë, është në kundërshtim me parashikimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës.*

27.1. Lidhur me këtë procedim penal, me nr. {***}⁴³, në vendimin e Komisionit është analizuar dhe konkluduar se: *subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në lidhje me shtetasin B. K., si dhe me personin e tretë, duke treguar mungesë të aftësive për njohuri ligjore, pasi nuk ka mbledhur të gjitha provat, duke u klasifikuar si mangësi, sipas nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016. [...] Komisioni vlerëson se në lidhje në këtë procedim penal, konstatohen mangësi sipas nenit 73/2-3 dhe nenit 74/5 të ligjit nr. 96/2016. Këto mangësi duhet të jenë pjesë e*

⁴¹ Sipas të dhënave të përfituara nga korrespondenca e Komisionit me ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, përkatësisht me shkresën nr. {***} prot., datë 21.07.2021, Tiranë.

⁴² Nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë kalim pronësie me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të lidhur më datë 08.03.2021, vajza e subjektit, së bashku me bashkëshortin e saj, R. H., kanë blerë nga palët shitëse L., M. dhe I. Th. dhe F. K., apartamentin nr. {***} me sip 59 m² dhe ap. nr. 2 me sip 93 m² në rrugën “{***}” në Tiranë, kundrejt çmimit në total prej 9.350.000 lekësh për të dy apartamentet, duke u bërë për pasojë bashkëpronare me 1/2 pjesë takuese në kartelat e pasurive të lëshuara nga ASHK.

⁴³ Procedimi penal nr. {***} gjendet gjithashtu i analizuar edhe në raportin e hartuar për vlerësimin e aftësive profesionale nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dosja nr. {***}, në grupin e çështjeve të përzgjedhura me short.

vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

27.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë procedim, duke pretenduar se:

Në vendimin objekt ankimi, KPK-ja ka marrë në shqyrtimin themelin çështjes dhe vetvetiu ka vlerësuar vendimmarrjen. Në rastin konkret, kam shpjeguar në mënyrë ezauruese besueshmërinë në ligj dhe prova të vendimit të pushimit të çështjes në tërësi. Provat e administruara në fashikullin e hetimit tregonin qartazi se shtetasi G. P. ishte përdorues i lëndës narkotike cannabis sativa, konfirmuar nga akti i ekspertimit toksikologjik. Sipas përcaktimeve të nenit 283/1 të Kodit Penal, ligjvënësi ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë doza të vogla dhe për përdorim vetjak, siç rezultonte rasti konkret, ku sasia e lëndës së sekuestruar, cannabis sativa, ishte 1,52 gram dhe poseduesi G. P. ishte përdorues i lëndës narkotike.

Arsyetimi i vendimit të pushimit për poseduesin e lëndës narkotike, natyrisht që përjashton nga përgjegjësia dhe ndjekja e mëtejshme penale si personin tjetër nën hetim B. K., ashtu edhe çdo person të tretë që paraqitet si mangësi e hetimit. Referuar procesverbalit të pyetjes për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të shtetasit B. K., konstatohej lehtësisht se ai ka deklaruar se është përdorues i lëndëve narkotike cannabis sativa, nuk është shpërndarës i tyre.

27.3. Lidhur me konstatimet e Komisionit për këtë procedim penal, trupi gjykues konstaton se ato qëndrojnë për sa u përket kundërshtive që konstatohen në arsyetimin e shkakut të pushimit të çështjes për personin nën hetim B. K., për të cilin ndonëse pranohet se është përdorues i lëndës narkotike, meqë ai deklaroi se është i tillë, sërish silltet në vëmendje se akti i ekspertimit toksikologjik ka konkluduar se nuk është i tillë, por ky akt ka gjithsesi vlerë provuese të kufizuar në kohë, për pasojë nuk mund të konfirmojë të kundërtën e deklaramit të vetë personin. Argumenti i përdorur nuk duket se ndjek një linjë logjike të mirëstrukturuar dhe krijon deformim të linjës arsyetuese të vendimit të pushimit. Pavarësisht kësaj, duket se sasia e vogël e lëndës narkotike të sekuestruar personit ndaj të cilit zhvilloheshin e hetimet, G. P., dhe konkluzioni i aktit të ekspertimit, sipas të cilit ai ishte përdorues i saj, në mungesë të të dhënave të tjera, duket se ka çuar subjektin në një vendimmarrje të vlerësuar sipas logjikës dhe leximit prej tij të situatës faktike të provuar, e cila nuk sugjeron për shkelje të rënda profesionale, të cilat mund të merren në analizë në kuptim të nënindikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë kuptim, trupi gjykues, në këndvështrim edhe të orientimit që jep vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, vlerëson se këto problematika nuk janë të tilla që meritojnë vlerësim brenda kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

28. Në vijim, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se *konkluzioni që Komisioni ka nxjerrë lidhur me denoncimin e z. P. M. e znj. F. M. është i gabuar dhe, si i tillë, është i pambështetur në ligj dhe në prova, duke kërkuar nga Kolegji mosmarrjen në konsideratë të vlerësimit të bërë për këtë procedim penal.* Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

28.1. Në vendimin e Komisionit, evidentohet se pranë këtij organi kanë paraqitur ankesa/denoncime⁴⁴ shtetasit P. e F. M., të cilët janë prindër të ndjerit M. M., i cili është vrarë më datë 31.07.2017, pas një konflikti fizik. Denoncuesit akuzojnë subjektin e rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit të çështjes, për mungesë hetimesh, shtrembërim të fakteve, me qëllim favorizimin e të pandehurve.

28.2. Komisioni, pasi ka verifikuar denoncimin e shtetasve P. dhe F. M. për procedimin penal {***}, të regjistruar për vrasjen e djalit të tyre, duke konsideruar se shpjegimet e subjektit gjatë hetimit nuk kanë qenë bindëse dhe se hetimi administrativ nuk ka cenuar pavarësinë e subjektit, ka konkluduar si vijon.

Komisioni ka konstatuar mangësi procedurale nga subjekti në lidhje me këtë procedim dhe, për këto mangësi, i ka kaluar barrën e provës. Më konkretisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk rezulton të ketë analizuar dinamikën e ngjarjes, me qëllim caktimin e përgjegjësisë penale për secilin të pandehur. Ai është referuar vetëm në deklaratimet e shtetasve të përfshirë në konflikt, por pa analizuar provat e tjera, si dhe shkallën e përgjegjësisë të secilit prej të pandehurve. Nga ai nuk janë analizuar veprimet aktive të shtetasve K. A., M. A. dhe E. B.. Subjekti nuk ka analizuar elementet përbërëse të figurës së veprës penale të moskallëzimit të krimit, si dhe nuk ka argumentuar se pse jemi përpara kësaj vepre. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar pamjet filmike.

Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë dhe pikën 54 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese⁴⁵, vlerëson se vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq nga subjekti i rivlerësimit, është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, duke qenë përpara gabimeve thelbësore dhe serioze që tregojnë mungesë të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, konstatuar këto gabime edhe nga gjykata më të larta, por dhe nga prokurori i çështjes që ka zëvendësuar subjektin.

28.3. Lidhur me këtë procedim penal, në analizë të akteve të fashikullit, konstatohen faktet si vijojnë.

i. Subjekti i rivlerësimit, më datë 01.08.2017, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprat penale të “Vrasjes me dashje” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, të parashikuara nga nenet 76-25 e 279 të Kodit Penal dhe, më datë 02.08.2017, për këto vepra penale, ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të “Arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” për shtetasit M. A., K. A., E. B. dhe D. B.. Kjo kërkesë rezulton të jetë pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është lënë në fuqi dhe nga gjykatat më të larta.

ii. Më datë 25.01.2018, përfaqësuesit ligjorë të prindërve të viktimës, P. e M. M., i kanë paraqitur Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkresën e emërtuar “*Memorie dhe kërkesë me shkrim mbi gjendjen që ndodhet procedimi penal i identifikuar me nr. {***}, datë*

⁴⁴ Ankesat nr. {***}, datë 17.05.2019; nr. {***}, datë 25.05.2018; nr. {***}, datë 12.06.2018.

⁴⁵ Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

01.08.2017, si dhe kërkesë për cilësimin ex novo të veprës penale, si dhe marrjen në pyetje të personave që kanë dijeni mbi faktet ende të padëgjua”, në të cilën, përveç nevojës për pyetjen e personave të tjerë që kanë dijeni për çështjen, kërkojnë edhe ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale nga “Vrasje me dashje” në “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78, pika 1 e Kodit Penal.

iii. Prej subjektit të rivlerësimit, për procedimin penal nr. {***}, nga data 01.08.2017 deri më datë 01.04.2018, janë kryer një sërë veprimesh procedurale dhe është zgjatur⁴⁶ dy herë afati i hetimeve. Sipas të dhënave të fashikullit të procedimit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

- a) Më datë 10.04.2018, ka marrë vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin D. B., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Vrasje me paramendim të shtetasit M. M.”, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal.
- b) Më datë 10.04.2018, ka marrë vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin E. B., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.
- c) Më datë 06.04.2018, ka marrë vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin M. A., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal.
- d) Më datë 06.04.2018, ka marrë vendim për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasin K. A., i cili akuzohet se ka kryer veprën penale “Moskallëzim i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

iv. Në datë “s’ka”, subjekti ka vendosur të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, për të pandehurit E. B., K. A. dhe M. A. sipas akuzave të evidentuara në paragrafin më sipër. Pas ndryshimit të kualifikimit ligjor të veprës penale për të pandehurit E. B., K. A. dhe M. A. (nga “Vrasje me dashje” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” të parashikuara nga nenet 76-25 e 279 të Kodit Penal, në “Moskallëzim krimi” të parashikuar nga neni 300 i këtij kodi), mbrojtësit e tre të pandehurve të mësipërm kanë kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit Procedurës Penale, me masën e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti, në seancat gjyqësore të shqyrtimit të kërkesave të të pandehurve për zëvendësim të masës së sigurimit, është shprehur dakord⁴⁷ me kërkesën e tyre për zëvendësimin e masës, duke u shprehur se kishin ndryshuar nevojat e sigurimit. Këto kërkesa janë pranuar nga gjykata, përkatësisht për

⁴⁶ Përkatësisht hetimet e procedimit penal {***}, më datë 01.11.2017, janë shtyrë fillimisht deri më datë 01.02.2018, dhe më pas janë shtyrë deri më datë 01.05.2018.

⁴⁷ Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. {***} akti, datë 16.04.2018, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së E. B., është evidentuar se: “Prokurori parashitroi se ishte dakord me kërkesën e përfaqësuesve të kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” me atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, pasi kishin ndryshuar nevojat e sigurimit dhe se masa e sigurimit personal i bindet rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

I njëjti shpjegim mbi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, rezulton të jetë përfshirë edhe në vendime vijuese të kësaj gjykate, me të cilat miratohen edhe kërkesat e kërkuesve M. A. dhe K. A. për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg” në “Detyrim për t’u paraqitur pranë Policisë Gjyqësore”.

E. B. më datë 16.04.2018, K. A. më datë 20.04.2018, M. A. më datë 23.04.2018, duke vendosur masën e sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur pranë Policisë Gjyqësore”.

28.4. Më pas, më datë 24.04.2018 (një ditë pas ndryshimit të masës së sigurimit të shtetasit M. A., kërkesa e të cilit ishte e fundit e shqyrtuara nga gjykata), subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga ky procedim penal, me pretendimin se ishte i paragjykuar nga prindërit e viktimës. Në kërkesë, ai referon faktin se ishte në dijeni të një kërkesë të prindërve të viktimës për zëvendësimin e tij, e cila mbante datën 12.04.2018, të protokolluar në prokurori më datë 13.04.2018. Më datë 25.04.2018, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e subjektit duke e zëvendësuar atë me një prokuror tjetër.

28.5. Në seancën paraprake të datës 22.05.2018, organi i akuzës i përfaqësuar nga një prokuror tjetër, ka kërkuar ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, duke e kualifikuar faktin penal sipas nenit 78-25 të K.Penal për të gjithë të pandehurit. Kjo kërkesë është miratuar nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, i cili, me vendim nr. {***} akti, datë 28.05.2018, ka vendosur kalimin për gjykim të dosjes penale nr. {***}, kundër të pandehurve D. B., E. B., M. A. dhe K. A. për veprën penale të “Vrasjes me paramendim”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78/1-25 të K.Penal.

28.6. Pas vendimit të gjykatës si më lart, më datë 13.06.2018, nga ana e organit të akuzës është kërkuar ndryshimi i masave të sigurimit për tre të pandehurit për të cilët ajo ishte caktuar si “Detyrim për paraqitje”, duke kërkuar vendosjen ndaj tyre të masës së sigurimit “Arrest në burg”. Kërkesa është pranuar nga gjykata për të tre të pandehurit, por vendimi është ekzekutuar vetëm për E. B., pasi dy vëllezërit A. rezultojnë se nuk janë gjendur në vendbanimin e tyre dhe janë gjykuar në mungesë. Këta dy të pandehur rezultojnë gjithashtu se nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës për masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, pasi nga data 14.05.2018, nuk janë paraqitur më para oficerit të policisë gjyqësore. Nga të dhënat e sistemit TIMS të administruar në fashikullin penal, rezultojnë se të dy këta shtetas kanë dalë nga Shqipëria më datë 27.05.2018.

28.7. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me procedimin penal {***} të ndjekur prej tij, duke ngritur pothuajse të njëjtat pretendime si ato që ka paraqitur në Komision, përkatësisht:

(i) Komisioni, duke marrë në shqyrtim këtë çështje, ka shkelur pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duke pretenduar se në rast se do të ndërhyhet nga organet e rivlerësimit në çështje që janë në shqyrtim e sipër, do të diktohej vendimi i gjykatave, të cilat aktualisht janë të ndikuara nga organet e rivlerësimit për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) konkluzioni i Komisionit për procedimin penal {***}, nuk qëndron për arsyet që subjekti ka paraqitur në Komision, të cilat nuk janë analizuar nga ky organ dhe, për pasojë, nuk janë marrë në konsideratë; (iii) Komisioni, në vlerësimin e këtij procedimi, ka marrë rolin e gjykatës dhe nuk argumenton përse nuk merren në konsideratë shpjegimet e subjektit; (iv) fakti që vendimi i subjektit, në cilësinë e prokurorit që ka ndjekur procedimin penal nr. {***}, nuk përputhet me vendimin e gjykatës, nuk do të thotë se ky vendim është i padrejtë pasi këtë duhet ta konfirmojë Gjykata e Lartë; (v) për të pandehurin E. B., subjekti shpjegon se ia ka deleguar oficerit të policisë gjyqësore marrjen e tij në pyetje dhe se ka qenë akti i ekspertimit ai i cili ka konkluduar për faktin se arma që ky i pandehur mbante, nuk plotësonte kushtet për t’u konsideruar armë e ftohtë; (v) thëniet e personit nën hetim E. B., janë marrë me rezervë pasi

nuk përputheshin me provat e tjera të administruara; (vi) ka dhënë dorëheqjen jo i ndikuar nga qëndrimi subjektiv i palës në proces, por është dhënë kur ai e ka vlerësuar të nevojshme ta paraqesë atë; (vii) vendimmarrja e tij është bazuar në provat përcaktuese, si: aktekspertimi, këqyrja e kufomës, këqyrja e pamjeve filmike, deklaratimet e personave të pranishëm në vendngjarje, të pasqyruara në aktin e njoftimit të akuzës.

28.8. Trupi gjykues vlerësoi konstatimet e Komisionit lidhur me këtë çështje brenda kompetencave kontrolluese e vlerësuese të organeve të rivlerësimit, në këndvështrim të parashikimeve të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Pas analizimit të tyre, në këndvështrim edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim, trupi gjykues vlerësoi se përgjithësisht qëndronin problematikat e konstatuara prej Komisionit dhe se në përmbledhje të tyre, duket se subjekt i rivlerësimit nuk kishte treguar në hetimin e këtij procedimi aftësitë e duhura profesionale dhe, me sjelljen e tij, kishte lënë me të drejtë gjurmë të një trajtimi favorizues të personave të hetuar për ngjarjen, të cilat, për pasojë, kanë një ndikim negativ në perceptimin e publikut për mënyrën se si ka funksionuar sistemi i drejtësisë dhe se ai ka dështuar në mbrojtjen e interesave të viktimave apo të dëmtuarve nga veprat penale, praktikisht grupit më vulnerabel në këtë kontekst. Ky perceptim është materializuar në vlerësimin e trupit gjykues në disa elemente procedurale por edhe jo të tillë, që rezultojnë nga aktet e fashikullit të këtij procedimi dhe mbi të cilat u arsyetua si më lart dhe parashtrihen në vijim.

28.9. Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur ndryshimin e cilësimit ligjor të faktit penal për të tre të pandehurit M. A., K. A. dhe E. B., nga ai i “Vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal në atë të “Moskallëzimit të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, mbështetur në një analizë të pjesshme të fakteve që kanë rezultuar gjatë hetimit penal. Arsyetimi i vendimit të pushimit, si me të drejtë ka konstatuar Komisioni, nuk përmban në pjesën e tij një analizë të plotë e të kujdesshme, e cila ishte veçanërisht e nevojshme për sensibilitetin e rastit, për secilën prej të dhënave që kanë rezultuar prej hetimit. Në këtë vendim, nuk rezulton të ketë një analizë e vlerësim mbi peshën dhe vlerën provuese në kualifikimin e duhur ligjor të faktit penal, të pamjeve filmike të regjistruara e të marra me cilësinë e provës në hetim. Nga këto pamje⁴⁸, duket se këta shtetas kanë pasur një rol aktiv në agresionin që i është bërë të ndjerit, M. M., duke kryer veprime të dhunshme ndaj tij, para dhe pas goditjes fatale me armën që i ka sjellë humbjen e jetës. Këto rrethana meritonin qoftë edhe në këndvështrim të vlerësimit të subjektit si prokuror i çështjes, një analizë të detajuar rreth kualifikimit të tyre ligjor në mënyrë të saktë. Mospërmendja dhe abstragimi i tyre në vendimin për ndryshimin e kualifikimit të veprës, tregojnë për një analizë pjesore/sipërfaqësore të provave, e cila, siç ka rezultuar më pas, ka favorizuar pozicionin procedural të këtyre të pandehurve.

28.10. Mangësi në analizën e provave rezulton edhe në drejtim të mosthellimit qoftë në hetim, qoftë në arsyetim të të dhënave që janë deklaruar nga këta persona me cilësinë e atyre që kanë dijeni për ngjarjen, të cilat duket se kanë informuar për një dinamikë të saj të ndryshme nga ajo që subjekti ka pranuar se është provuar prej hetimit. Duket se subjekti nuk ka kryer çdo veprim

⁴⁸ Sipas të dhënave që rezultojnë nga vendimet gjyqësore që kanë gjykuar çështjen, por edhe nga këqyrja e drejtpërdrejtë që ka bërë Komisioni, por edhe trupi gjykues i tyre.

hetimor të nevojshëm dhe nuk ka arsyetuar mbi kundërshtitë në deklaratimet e tyre, veçanërisht ato të shtetasit E. B., në raport me ngjarjen dhe rolin e secilit prej personave të përfshirë në të. Ai ka munguar të marrë në këtë drejtim edhe deklaratime të plota të shtetasve K. A. dhe M. A. për rolin e tyre në konflikt, në kushtet që ata kanë mohuar përfshirjen e tyre fizike, e cila rezulton e dukshme nga pamjet filmike. Mungesa e këmbënguljes në hetimin dhe përfundimin e të dhënave të vlefshme për hetimin, nga personat e përfshirë në të, pavarësisht nivelit të përdorimit të tyre në varësi të statusit të tyre procedural, tregon për një mungesë të theksuar të dilijencës në rastin konkret, e cila e sugjeron atë në nivel maksimal.

Gjithashtu, në vendimin e ndryshimit të kualifikimi ligjor, trupi gjykues, ashtu siç ka evidentuar edhe Komisioni, konstaton një mungesë të plotë të analizës së elementeve të veprës penale të moskallëzimit të krimit. Duket se subjekti ka munguar ta kryejë atë pikërisht për faktin se ndërsa ajo domosdoshmërisht kryhet nëpërmjet mosveprimit, në rastin konkret, dukshëm sjellja e të pandehurve ishte vepruese dhe agresive ndaj viktimës, për pasojë sjellja në vëmendje e secilit prej elementeve të kësaj vepre penale, do të evidentonte edhe defektet e rëndësishme në arsyetimin se kjo vepër ishte konsumuar.

28.11. Gjithashtu, siç është parashtruar më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka konkluduar për dërgimin e çështjes në gjyq në përfundim të hetimit, duke akuzuar të pandehurit D. B. për veprën penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal, ndërsa tre të pandehurit e tjerë për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Nga dinamika e ngjarjes së pranuar prej vetë subjektit, rezulton se personat e përfshirë në konflikt, janë mbledhur në vendin e ngjarjes jo rastësisht, por pasi janë thirrur prej njëri-tjetrit, dhe duke u bërë evident edhe shkaku i këtij takimi. Sipas këtyre fakteve, veprimet/mosveprimet e të pandehurve M. e K. A. e E. B. nuk mund të kufizoheshin logjikisht deri në nivelin e moskallëzimit të krimit, në një kohë që, sipas vetë prokurorit, krimi ishte i paramenduar se do të kryhej dhe këta individë ishin thirrur në vendngjarje prej vetë ekzekutorit të tij. Ana subjektive që shoqëron kryerjen e kësaj vepre, edhe teorikisht i referohet dijenisë për kryerjen e saj, që merret gjatë kryerjes ose pas saj dhe në mungesë të plotë të veprimeve në ndihmë të autorit, ndërsa në rastin konkret, edhe në versionin e akuzës së ngritur prej subjektit, duket se vrasësi që kishte paramenduar kryerjen e tij, kishte thirrur për shoqërim/ndihmë shokët e vet, të cilët ndonëse në dijeni të këtij qëllimi, vetëm e kishin moskallëzuar atë. Me fjalë të tjera, rezulton një nonsens logjik edhe në ngritjen e akuzave si më sipër.

28.12. Krahas elementeve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson të rëndësishme në këtë analizë sjelljen e subjektit të rivlerësimit në raport me kërkesat e prindërve të viktimës, të cilët, me cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë sipas përcaktimeve të nenit 58, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, gëzojnë disa prej të drejtave të viktimës në proces. Në këtë kuptim, konstatohet një komunikim intensiv kërkesash e memoriesh prej tyre dhe avokatëve të tyre drejt subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar hetime më të thelluara apo kërkesa për marrje provash e analizash të ndryshme të fakteve nga ato që ka konsideruar subjekti. Kjo marrëdhënie procedurale, por edhe që duket e pamundur të shkëputet nga konteksti njerëzor, për shkak të rrethanave të rastit, ka kulmuar me paraqitjen prej tyre të një kërkesë për përjashtimin e tij nga hetimi i çështjes, pasi ata janë njoftuar për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës për tre të pandehurit e përmendur më lart. Nga sa evidentuar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti

i rivlerësimit, edhe pas marrjes dijani të kërkesës⁴⁹ së prindërve të viktimës, të datës 12.04.2018, për përjashtimin e tij nga hetimi, përgjatë harkut kohor nga administrimi i kërkesës, më datë 13.04.2018, e deri me datë 24.04.2018, kur subjekti ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga procedimi penal {***}, me argumentin se është në dijani të kërkesave të prindërve të viktimës dhe se është i paragjykuar prej tyre, rezulton se ka kryer veprimtari procedurale të rëndësishme, e cila ka shkuar praktikisht në favor të të pandehurve, si: (i) ka marrë pjesë si përfaqësues i akuzës në seancat gjyqësore të shqyrtimit të kërkesave të të pandehurve për zëvendësim të masës së sigurimit nga “Arrest me burg” në “Detyrim paraqitje pranë Policisë Gjyqësore” dhe është shprehur dakord me këto kërkesa⁵⁰; (ii) këto kërkesa janë zhvilluar dhe miratuar nga gjykata në disa seanca gjyqësore të zhvilluara në ditë të ndryshme, përkatësisht: për E. B. më datë 16.04.2018, për K. A. më datë 20.04.2018, për M. A. më datë 23.04.2018, kohë gjatë së cilës subjekti kishte dijani për kërkesën e paraqitur prej prindërve të viktimës për zëvendësimin e tij, duke pasur njëkohësisht kohën e mjaftueshme për të reaguar karshi saj; (iii) ai ka kërkuar të heqë dorë nga qenia si prokuror i çështjes në datën 24.04.2018, vetëm pasi ishte shqyrtuar dhe vendosur zëvendësimi i masës së sigurisë për të pandehurin e fundit ndër ata që kishin paraqitur kërkesat, duke përcjellë perceptimin se qenia e tij në seancat përkatëse ishte e nevojshme për të mbështetur kërkesat e tyre; (iv) subjekti ka kërkuar të heqë dorë nga trajtimi i mëtejshëm i çështjes, mbështetur në argumentin se prindërit e viktimës e kanë paragjykuar atë, ai nuk ka lejuar që për kërkesën e tyre të shprehej drejtuesi i prokurorisë sipas parashikimit të nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale, por i ka paraprirë këtij vendimi duke u dorëhequr prej saj në bazë të nenit 26 të këtij Kodi, ndonëse arsyeja e paraqitur nuk është asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 17 i Kodit, për të cilin prokurori lejohet të bëjë një kërkesë të tillë. E gjithë kjo situatë e zhvilluar minimalisht në limitet e interpretimit të ligjit, krijon dyshime të arsyeshme për sjelljen jokoherente të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e kësaj suate. Pra, ndërsa ai pranon se ka kushte për t’u përjashtuar, qoftë edhe mbi arsyet e mosbesimit të prindërve të viktimës, ai e bën këtë në një moment procedural, pasi prezenca e tij në kushtet e “mosbesimit” të parashtruar prej tyre, e kishte dhënë efektin e vet, nëpërmjet qëndrimit dakordësues në seancat për zëvendësimin e masave të sigurimit.

⁴⁹ Më datë 16.04.2018, përfaqësuesit ligjore prindërve të viktimës z. P. e M. M., i kanë paraqitur një kërkesë tjetër Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorit të Përgjithshëm shkresën e emërtuar “Parashtrim ankues me kërkesë kontestuale mbi parregullsitë e vërejtura në administrimin e procedimit penal {***}, në të cilin renditen një sërë veprimesh të konsideruara nga kërkuesit si shkelje procedural i kërkohet Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zëvendësimi i prokurorit Artan Lulaj, pasi ekzistojnë arsye serioze në lidhje me ushtrimin e detyrës në mënyrën e duhur nga ky prokuror.

⁵⁰ Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. {***} akti, datë 16.04.2018, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së E. B., është evidentuar se: “Prokurori parashtror se ishte dakord me kërkesën e përfaqësuesve të kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” me atë të “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, pasi kishin ndryshuar nevojat e sigurimit dhe se masa e sigurimit personal i bindet rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet”.

I njëjti shpjegim mbi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes rezulton të jetë përfshirë edhe në vendime vijuese të kësaj gjykate, me të cilat miratohen edhe kërkesat e kërkuesve M. A. dhe K. A. për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg” në “Detyrim për t’u paraqitur pranë Policisë Gjyqësore”.

28.13. Rrethanat që kanë shoqëruar zëvendësimin e subjektit si prokuror i çështjes me një prokuror tjetër, të cilat kanë diktuar ndryshimin e kualifikimeve ligjore të veprës për të tre të pandehurit dhe ndryshimin e masave të sigurisë ndaj tyre, vendimet e dënimit të dhëna nga gjykatat deri në nivelin e gjykatës së apelit, sipas akuzës së vrasjes me dashje të kryer në bashkëpunim, sipas parashikimeve të neneve 76 dhe 25 të Kodit Penal për të katër të pandehurit, ndonëse ende jo deri në gjykimin e kësaj çështjeje në Kolegj, të konfirmuara nga një vendim përfundimtar i Gjykatës së Lartë, mbështesin drejtësinë e qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni dhe nga këto forumeve vendimmarrëse, si edhe konfirmojnë mangësitë e treguara nga subjekti i rivlerësimit në trajtimin e kësaj çështjeje.

28.14. Për të gjitha sa u arsyetua më lart, trupi gjykues vlerësoi se ndonëse këto mangësi nuk rezultojnë të jenë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i paaftë në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, ato janë të vlefshme dhe u konsideruan në vijim, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit të këtij procesi.

29. Në përfundim, trupi gjykues u ndal në shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai kundërshtoi si të padrejtë dhe të pabazuar ligjërisht, konkluzionin e Komisionit se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

29.1. Lidhur me këtë konkluzion, Komisioni ka arsyetuar se në këtë vlerësim janë konsideruar disa gjetje që kanë dalë nga procesi i rivlerësimit të subjektit në lidhje me: **(i)** qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë e tij dhe të personit të lidhur, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit; **(ii)** fshehjen nga subjekti i ndërtimit të objektit me sipërfaqe 110 m²; si dhe **(iii)** faktet e sjella në vëmendje nga denoncimi dhe të provuara gjatë hetimit administrativ të procedimit penal, objekt i denoncimit, pasqyrojnë gabime procedurale që tregojnë mangësi profesionale, mungesë angazhimi dhe përgjegjshmërie në përfaqësimin e interesit publik, që ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e publikut për organet e drejtësisë.

Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit duke pretenduar se: neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 nuk përlligj arsyetimin e vendimit nr. 497, datë 13.01.2022, pasi shkelje që duhet të rezultojnë në kuptim të kësaj pike, duhet të jenë të tilla që klasifikohen si "sjelljet më të rënda" të subjektit në raport me kriterin përkatës. Jo vetëm kaq, por duhet të jenë të tilla që të cenojnë besimin e publikut dhe subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në rastin konkret, vetë konkluzionet e KPK-së, edhe nëse ato të qëndronin, nuk janë të tilla që të evidentojnë sjellje të miat të atij niveli që cenon besimin e publikut te drejtësia. Për sa me sipër, rezultoi se KPK-ja, duke zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka cenuar qëllimin e ligjvënësit në këtë nen dhe qëllimin e ligjit në tërësi, si dhe të vetë Kushtetutës.

29.2. Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimeve të subjektit, konstaton së pari, se Komisioni ka zbatuar drejt kriteret për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili është thirrur

për zbatim pas një vlerësimi të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit dhe tërësor të procedurave, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e këtij ligji. Për pasojë në kuptimin formal, Komisioni ka qenë në kushtet kur mund të kryente një vlerësim të përgjithshëm të tri kritereve, për sa kohë që të tria kriteret ishin hetuar prej tij dhe kishte një konkluzion për secilin prej tyre.

29.3. Duke vlerësuar konkluzionin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, trupi gjykues analizoi disa rrethana që u konstatuan në dy kriteret e rivlerësimit, atë të pasurisë dhe të aftësive profesionale, të cilat, në vlerësimin e trupit gjykues, ndërsa nuk ishin elemente përbërëse për të konkluduar për pamjaftueshmëri/papërshtatshmëri brenda secilit prej kritereve, të konsideruara/vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin që me të drejtë Komisioni ka arritur, se subjekti e ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

29.4. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim në konsideratë të qëndrimeve të mbajtura më sipër në këtë vendim, në kuptim të përcaktimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në konsideratë të elementeve të mëposhtme, por jo vetëm, si:

29.5. Mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë, si dhe në pyetësin standard të plotësuar gjatë hetimit administrativ në Komision, të pronësisë mbi objektin 1 kat me sip. 110 m² në Sarandë, të cilin subjekti e ka shitur më datë 24.01.2004, që përkon me periudhën kur ai ushtronte funksionin e prokurorit. Siç është elaboruar në pjesën arsyetuese më sipër, trupi gjykues ka konkluduar se subjekti ka ndërtuar mbi truallin prej 662 m² një objekt njëkatësh, i cili më pas është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme në ZVRPP Sarandë dhe është shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes në datën e mësipërme, fakt që provon se ky objekt ka qenë i regjistruar në këta regjistra të paktën deri në fund të vitit 2003 dhe, si i tillë, do të duhej të deklarohet se ishte në pronësi të subjektit në deklaratën fillestare të pasurisë. Ndonëse ky element nuk përbën një shkak që mund të ngrihet në nivelin e një shkelje të drejtpërdrejtë që shkakton shkarkimin nga detyra, ai përbën gjithsesi një shkelje të detyrimeve që i buronin subjektit nga ligji nr. 9049/2003.

29.6. Mosdeklarimin e përdorimit nga vajza e tij në vitet 2011-2014, të automjetit tip BMW, i cili ishte në pronësi të shtetasit G. P., përdorimin e të cilit subjekti nuk e ka deklaruar as në pyetësin standard të hetimit administrativ. Sikurse është arsyetuar më lart, ndonëse mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i kësaj marrëdhënieje nuk ngrihet detyrimisht në nivelin e një deklarimi të pasaktë, duke qenë se nuk provohet se mjeti ka ekzistuar realisht dhe ka qenë funksionale marrëdhënia e përdorimit, trupi gjykues ka vlerësuar se sjellja e subjektit në drejtim të ekspozimit dhe qartësisë të kësaj marrëdhënieje nuk ka qenë e sinqertë dhe ka synuar mosnjohimin e saj për organet e rivlerësimit, por edhe më herët për organet e kontrollit të zakonshëm të pasurisë. Kjo sjellje e parë në këndvështrim të arsyetimit se duket se të drejtat që vajza e tij ka pasur mbi këtë pasuri nuk kanë qenë thjesht prej përdorueseje, i jep kësaj situatë vlerën e posaçme për t'u konsideruar në kuadër të një vlerësimi të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndonëse ajo më vete u vlerësua e pakonsiderueshme si një shkak autonom shkarkimi.

29.7. Mungesa e dhënies së shpjegimeve për pagesën për lejen e ndërtimit në vitin 2001, lidhur me truallin 314 m², Komisioni ka arsyetuar se subjekti nuk ka qenë i gatshëm të japë shpjegime bindëse rreth pagesës për lejen e ndërtimit të miratuar për të në vitin 2001, lidhur me një

ndërtim në truallin prej 314 m² në Sarandë, duke e vënë Komisionin në vështirësi/pamundësi për të konkluduar përfundimisht nëse ky ndërtim ishte kryer apo jo, apo për vlerën e tij, si edhe rreth vërtetësisë së deklaramente të subjektit për gjendjen e kësaj pasurie. Për shkak të faktit se subjekti ka qenë evaziv dhe joshpjegues lidhur me këtë çështje, Komisioni ka konkluduar se ai nuk mund të hetojë më tej dhe të marrë një qëndrim përfundimtar rreth kësaj situatë. Kjo sjellje e subjektit, duket se e vendos atë nën dritën e në mungesë bashkëpunimi, por edhe nën perceptimin e një papërgjegjësie në raport me detyrimet që ky proces imponon për subjektet e rivlerësimit, sjellje e cila po ashtu u mbajt në vëmendje të analizës së trupit gjykues në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

29.8. Mungesën e deklaramente të shpenzimeve për rindarje të banesës në vitin 2014 në deklaratën periodike vjetore, sipas detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 9049/2003. Kjo rrethanë, e cila u analizua në pjesën arsyetuese në funksion të përlllogaritjes së këtij shpenzimi, u provua se ka krijuar vështirësi dhe ndoshta edhe pasaktësi në drejtim të kryerjes së analizës financiare për llogari të procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në DPV-në e vitit 2015 të deklaronte çdo shpenzim të kryer përmbi vlerën 500.000 lekë, ndërsa rezulton se ai ka munguar të deklarojë një të tillë në vlerën prej 2.000.000 lekësh. Në proces u arrit të merrte një formë të pranueshme analiza financiare lidhur me këto shpenzime, për shkak të pasjes gjurmë në dokumentacionin bankar dhe në organet e pushtetit lokal që kishin dhënë leje për rikonstrukcion, si edhe në dritën e një versioni garantist që trupi gjykues çmoi të interpretojë të dhënat e këtyre akteve, të cilat gjithsesi evidentuan edhe këtë shkelje të ligjit nga ana e subjektit, e cila u vlerësua gjithashtu në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

29.9. Pasaktësitë në deklaratën *vetting*, të konstatuara edhe prej Komisionit, të cilat lidhen me deklarimin si burime të krijimit të pasurisë apartament të të ardhurave të përfituara nga shitja e trojeve në Sarandë, të cilat objektivisht nuk mund të kishin shërbyer si të tilla pasi ishin krijuar në kohë pas blerjes së apartamentit, tregojnë gjithashtu për një qasje joserioze dhe të përgjegjshme ndaj deklaramente në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila, ndonëse nuk mund të shërbejë si një shkak që penalizon drejtpërdrejt subjektin, vlerësohet në kontekstin e një vlerësimi të përgjithshëm, bashkë me konkluzionet e tjera të përmendura në këtë pjesë të arsyetimit.

29.10. Mangësitë e evidentuara në trajtimin e procedimit penal nr. {***}, u vlerësuan të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti është i paaftë profesionalisht, por u konsideruan me një peshë të rëndësishme në analizën e të gjitha problematikave që u përmendën edhe më lart. Trupi gjykues vlerësoi se veçanërisht sjellja procedurale e subjektit në trajtimin e këtij procedimi, duket se afekton besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke pasur në konsideratë edhe faktin që ngjarja ka qenë publike, tejet sensitive për shkak të rrethanave se si ka ndodhur, faktit se viktimat ishin në moshë fare të re, si edhe ndjeshmërisë së lartë publike për shkak të vëmendjes së shtuar drejt hetimit, të tërhequr nga këmbëngulja e prindërve të tij për zbardhjen e së vërtetës. Në këto kushte, diligenca publike drejt këtij hetimi ka qenë e lartë. Për pasojë, edhe mangësitë e konstatuara në ushtrimin e funksioneve prej prokurorit me peshë të posaçme ndikuese.

29.11. Sa më sipër, trupi gjykues, njësoj si Komisioni, problematikave të mësipërme i vlerësoi të mjaftueshme për të konkluduar se nëpërmjet sjelljes, në raport me kriterin e vlerësimit të

pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për shkaqe që nuk janë përfshirë në vlerësimin autonom të secilit kriter, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

30. Në përfundim, edhe pse disa nga shkaqet e ankimit të subjektit u gjetën të drejta, në vlerësim dhe analizë të qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe për shkak të disa problematikave që lidhen me këtë kriter dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale, ai ka cenuar edhe besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.
31. Për sa më lart, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit objekt gjykimi është marrë në zbatim të drejtë të legjislacionit në fuqi e mbështetur në faktet e rezultuara nga hetimi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënin në fuqi të vendimit nr. 497, datë 13.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Lulaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 15.10.2024

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi